



BASHKIMI I SINDIKATAVE TË PAVARURA TË KOSOVËS

UNIJA NEZAVISIH SINDIKATA KOSOVA

THE UNION OF INDEPENDENT TRADE UNIONS OF KOSOVO

***Ekonomia informale në Kosovë:
Cili është roli i sindikatave?***

Falënderime

Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës dëshiron të falënderojë Konfederatën Ndërkombëtare të Sindikatave të Lira (ICFTU) e cila sponsoroi tryezën e rumbullakët dhe publikimin e diskutimeve në kuadër të programit mbi Ekonominë Informale në Evropën Qendrore dhe Lindore që është mbështetur bashkërisht nga ICFTU dhe Zyra për Aktivitetet e Punëtorëve (ACTRAV) e Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO).

Poashtu falënderojmë dhe Projektin e ILO-s për Punësimin e të Rinjve në Kosovë për mbështetjen e dhënë në organizimin e tryezës së rumbullakët dhe për të dhënat teknike të dhëna gjatë takimit si dhe për finalizimin dhe bashkëfinancimin e këtij publikimi.

Dhe një falënderim i fundit shkon për të gjithë pjesëmarrësit e tryezës së rumbullakët për komentet e dobishme dhe konstruktive të tyre.

Përmbajtja

Hyrje	1
Informaliteti në Kosovë: Determinantet dhe konteksti	2
Instrumentet e mbrojtjes së fuqisë punëtore dhe aplikimi i tyre	5
Veprimet e mundshme të sindikatave	7
Konkluzionet dhe rekomandimet	8

Aneksat

Aneksi I Lista e Pjesëmarrësve

Aneksi II Programi i Ttryezës së Rrrumbullakët

Aneksi III Përmbledhje Ekzekutive: Sindikatat dhe Sektori Informal:
Drejt një Strategjie Gjithpërfshirëse

Hyrje

1. — Ekonomia informale është rritur me ritëm rapid në mbarë botën, sidomos në shtetet e tranzicionit dhe ato në zhvillim. Vetëm në Evropën Qendrore dhe Lindore, Konfederata Ndërkombëtare e Sindikatave (ICFTU) ka llogaritur se 10 milionë njerëz në vitin 2002 ishin punëtorë informal. Ky numër është duke u rritur për çdo vit. Termi ekonomi informale po përdoret gjithnjë e më shpesh për të përfshirë kompleksitetin dhe diversitetin e ndërmarrjeve dhe punëtorëve që punojnë në informalitet¹. Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO) përshkruan gjendjen e punëtorëve dhe ndërmarrësve informal si pasojë e muungesës së punës të përshtatshme: cilësia e ulët, vende pune me produktivitet dhe paga të ulëta, pa mbrojtje sociale dhe të pambuluara me ligj. Mungesa e përfaqësimit dhe zërit janë më shumë të theksuara në ekonominë informale dhe kryesisht në mesin e punëtorëve të reja, pra femrave.

2. — Dhënia e zërit dhe përfaqësimit për punëtorët dhe ndërmarrësit në ekonomi informale kërkon organizime, struktura dhe qasje të reja të politikave. Nuk ekziston ndonjë strategji e vetme dhe e prerë për të reaguar ndaj sfidës që paraqesin diversiteti dhe nevojat e punëtorëve informal. Prandaj, hapi i parë është të kuptohen shkaktarët dhe të identifikohen grupet e punëtorëve që janë të angazhuar në ekonominë informale, dhe prioritetet e tyre.

3. — Për të ndriçuar sado pak ekonominë informale, Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës (BSPK) me mbështetje të Konfederatës Ndërkombëtare të Sindikatave të Lira (ICFTU) dhe me ILO-ns më 19 Tetor 2005, ka organizuar një tryezë të rumbullakët për të diskutuar madhësinë e ekonomisë informale në Kosovë dhe rolin e Qeverisë, sindikatave dhe organizatave të punëdhënësve për të konfrontuar sfidat e imponuara nga punësimi informal. Tryeza e rumbullakët e cila kryesohej nga nenkryetari Zëvendëskryetari i BSPK-së u vijua nga përfaqësues të IPVQ-ve të Kosovës, sindikatave, organizatave të punëdhënësve dhe të institucioneve hulumtuese (shih aneksin I).

4. — Ky raport është një përmbledhje e rrjedhës së diskutimeve, konkluzioneve dhe rekomandimeve për veprime të ardhshme. Këtu është përfshirë edhe përmbledhja ekzekutive e dokumentit të ILO-s Sindikatave dhe Sektori Informal: Drejt një Strategjie Gjithëpërfshirëse e përgatitur për Simpoziumin Ndërkombëtar të Sindikatave të mbajtur në Gjenevë më 1999. Versionet në Anglisht dhe Shqipe të kësaj përmbledhjeje ekzekutive u janë shpërndarë pjesëmarrësve si dokument për diskutim (anex III), e cila është shpërndarë tek pjesëmarrësit për diskutim në të dy gjuhët Angleze dhe Shqipe (aneksi III).

¹ ILO: "Rezoluta për punë të përshtatshme dhe ekonominë informale", Provisional Record Nr. 25, Konferenca Ndërkombëtare e Punës, Sesioni i 90-të (Gjenevë, 2002), paragrafi 5, mund ta gjeni në <http://www.ilo.org/public/english/standards/relm/ilc/ilc90/comreps.htm> (2005).

Informaliteti në Kosovë: Determinantet dhe konteksti

5. — Vlerësimi apo matja e ekonomisë informale dhe punësimit informal nuk është detyrë gjithaq e lehtë. Pjesëmarrësit përdornin termin ekonomi informale dhe punësim informal në mënyra të këmbyeshme, duke indikuar se nevojitet një elaborim më i detajuar i këtij fenomeni. Kryesuesi i tryezës së rrumbullakët filloi diskutimin duke theksuar se esenca e aktiviteteve të sindikatave është e përqëndruar në qëllimin që të garantohen kushte të përshtatshme pune për të gjithë punëtorët. Ende nuk ka informata të sakta mbi madhësinë e ekonomisë informale dhe mbi kushtet e punës të punëtorëve informal, mirëpo ekziston bindja se ky fenomen është i tejshfaqur. Punëtorët informal ndahen në tri grupe kryesore: pronarë ose punëdhënës të mikrondërmarrjeve të cilët punësojnë disa punëtorë që nuk janë në shënjestër të aktiviteteve të sindikatave, por mund të jenë partnerë negociues për mbrojtjen e punëtorëve informal. Grupi i dytë përbëhet nga të vetëpunësuarit, që punojnë pavarisvetanakisht apo me punëtorë pa pagesë. Grupi i tretë përfshinë punëtorët vartës, të angazhuar në punësim të kohëpaskohshëm apo me punësim të plotë (punëtorët me pagë, përgjithësisht pa kontratë formale pune dhe që punojnë në baza të rregullta apo të kohëpaskohshme, por edhe punëtorët pa pagesë, ku përfshihen anëtarët e familjes, dhe punëtorët nga shtëpia).

6. — Koncepti i aktiviteteve të ekonomisë informale duhet të veçohet nga aktivitetet e ekonomisë së nëntokës dhe nga aktivitetet ilegale. Ky definicion bën dallim ndërmjet atyre aktiviteteve, që si rezultat i të hyrave të ulëta që gjenerojnë, nuk mund t'ia lejojnë vetes shpenzimet e legalizimit dhe atyre që, pavarësisht asaj se janë profitabile, qëllimisht i shmangen autoriteteve publike që të ikin nga taksat e tatimet². Aktivitetet e nëntokës paraqesin thyerje të kodit civil. Ndërsa aktivitetet ilegale, janë ato aktivitete që ndalohen me kodin Penal të Kosovës kriminale (për shembull trafikimi i drogës, qenieve njerëzore, etj.).

7. — Deri më sot, diskutimi i ekonomisë informale në Kosovë nuk ka marrë vëmendjen e duhur. Përpjekjet e Kosovës janë koncentruar në lehtësimin e rimëkëmbjes ekonomike dhe infrastrukturore, në hartimin e kornizës bazë kushtetuese dhe në arritjen e standardeve për Kosovën³. Aktivitetet primare të Qeverisë janë orientuar në përmirësimin e administratës publike, në arsim, dhe gjithnjë e më shumë në zhvillimin ekonomik dhe rritjen e punësimit. Qeveria e Kosovës rishtazi ka filluar punët përgatitore për hartim të Planit Zhvillimor të Kosovës, i cili do të precizojë aktivitetet dhe veprimet e nevojshme për të siguruar zhvillim të qëndrueshëm e të paanshëm ekonomik.

² ILO: Puna e përshtatshme dhe ekonomia informale, Raporti VI(1), KNP, Sesioni i 90-të (Gjenevë, 2002), në <http://www.ilo.org/public/english/standards/relm/ilc/ilc90/comreps.htm> (2005).

³ Standardet për Kosovën janë tetë synime prioritare që Qeveria është angazhuar t'i arrijë në mënyrë që të vendosen institucione demokratike funksionale, sundimi i ligjit dhe liria e lëvizjes. Këto standarde dhe plani i implementimit të tyre, janë pajtuar ndërmjet Qeverisë së Kosovës dhe Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) në Dhjetor të vitit 2003. Për më shumë informata shikoni <http://www.unmikonline.org/standards> (2005).

8. — Gjatë tryezës së rrumbullakët, pjesëmarrësit filluan një debat të nxehtë mbi determinantet e informalitetit në Kosovë. Në Raportin e ILO-s të vitit 2002, theksohet se ekzistojnë shumë forca ekonomike, politike dhe sociologjike që përcaktojnë shumë forcë ekonomike informale në shtetet e tranzicionit dhe shtetet në zhvillim. Tepricat e fuqisë punëtore, zhvillimi i dobët ekonomik dhe/ose ristrukturimi ekonomik, rregulloret dhe praktikatat komerciale, administrimi joefektiv i punës shpesh kontribuojnë në rritjen e punësimit informal.⁴

9. — Sa i përket rregullimit të shkallës së ekonomisë informale u përmendën kryesisht tri lloje rregulloresh: i) rregulloret komerciale dhe të biznesit për rregullim të themelimit dhe punës së ndërmarrjeve, ii) ligji mbi të drejtat pronësore, dhe iii) ligjet e punës për qeverisje të marrëdhënieve të punës dhe për të drejtat dhe mbrojtjen e punëtorëve. Rregullat stërngarkuese dhe të hartuara jomirë të shoqëruara me burokraci joefikase rrisin shpenzimet e transakcioneve dhe dekurajojnë zbatimin. Në shpenzime të transakcioneve hyjnë: kostot dhe procedurat e nevojshme për regjistrim të biznesit, për marrje të lejes (licensës), për marrje të tokës dhe shërbimeve (telefon, ujë, rrymë), qasja në lëndën e parë dhe në burime të furnizimit, taksat, shpenzimet e punës dhe ato sociale. Poashtu edhe mënyra e administrimit të ligjeve dhe rregulloreve mund të paraqesë ngarkesë shtesë, sidomos për kompani të vogla.

10. — Vlerësimi i numrit të kompanive informale është mjaft i vështirë, por numri dhe karakteristikat e punëtorëve informal mund të zbulohen përmes futjes së disa pyetjeve shtesë në anketat e deritanishme të fuqisë ekzistuese punëtore për të gjithë të punësuarit, pavarësisht statusit të tyre të punësimit (të punësuar, të vetëpunësuar, anëtar familjeje, etj.). Dy anketime, të bëra jo fort moti në Kosovë, kanë siguruar disa indikacione mbi praktikatat e punësimit informal.⁵ Bazuar në anketën e Bankës Botërore, rreth gjysma e punësimit në Kosovë është punësim informal. Nga totali i të punësuarve, më shumë se 49 % ishin të punësuar informal, sipas dy kriterëve të ILO-s: (a) nëse kishin nënshkruar kontratë pune, dhe (ii) nëse ndërmarrja ishte e regjistruar. Shkalla e informalitetit të vlerësuar ishte më e lartë bazuar në kriterin se nëse kompania paguante apo mbante tatimin në të ardhura (67 përqind e respondentëve, bazuar në këtë standard, ishin të punësuar informal).

11. — Ngjashëm edhe me anektën e ILO-s të tranzicionit nga shkolla në punë, ku u pa se 50 përqind e të rinjve të punësuar ishin punëtorë informal dhe 73 përqind e tyre nuk ishin të përfshirë në kuadër të sistemit të sigurimit social. Mungesa e të dhënave të sakta mbi popullsinë dhe tregun e punës në Kosovë vetëm sa vështirëson përpjekjet për vlerësimin e punësimit informal. Një

⁴ ILO: Puna e përshtatshme dhe ekonomia informale, Raporti VI(1), KNP, Sesioni i 90-të (Gjenevë, 2002), në <http://www.ilo.org/public/english/standards/relm/ilc/ilc90/comreps.htm> (2005).

⁵ Corbanese, V., Rosas, G., Tranzicioni i të rinjve drejt punës së përshtatshme: Dëshmi nga Kosova, ILO, Gjenevë (pritet të dalë së shpejti); Banka Botërore, Studim i tregut të punës të Kosovës: sfidat e politikave të punësimit formal dhe informal, Washington D.C., (2003).

tjetër faktor që duhet vlerësuar edhe më shumë është vlerësimi i kontributit të ndërmarrjeve informale për Bruto Prodhimin Vendor (BPV) dhe vlerësimi i të hyrave (fitimeve) të humbura. Gjatë rrjedhës së tryezës, Ministria e Ekonomisë dhe Financave vlerësoi se, nëse punësimi informal është rreth 50 përqind kjo nënkupton që Kosova në vit humb 4-5 milion Euro nga tatimi në paga dhe humbje të kontributeve pensionale prej rreth 7-8 milion Euro në vit.

12. — Korniza rregullative e Kosovës konsiderohet e favorshme për zhvillim të biznesit: taksat doganore, shkalla e tatimeve dhe kosto e punës dhe mbrojtjes sociale janë ndër më të ulëtat në Regjionin e Qendrorë dhe Lindore (EQL-së). Mirëpo, gjatë disa hulumtimeve të fundit të bëra me punëdhënësit janë identifikuar disa pengesa fiskale të cilat *de facto* paraqesin asgjë më shumë veçse një barrë për aktivitetet e kompanive. Komuniteti i biznesit në Kosovë, konsideron se TVSH-ja për tregti dhe politikat tarifore janë pengesë për prodhuesit vendorë të cilët importojnë lëndën e parë dhe produkte gjysëm të gatshme. Faktorët që pengojnë ose parandalojnë themelimin e një kompanie janë kryesisht mungesa e kapitalit, qasja e dobët në shërbime financiare dhe konkurenca me firma vendore ose të huaja. Për ndërmarrjet ekzistuese, vështirësi kryesore për operimin e një biznesi është qasja e dobët në shërbime financiare, konkurenca jofer apo informale, niveli i tarifave dhe taksave të zbatuara për importin e mallrave kapitale dhe lëndës së parë si dhe shpenzimet administrative.

13. — Sistemi i administrimit të taksave është themeluar jo moti dhe kapaciteti i administratës publike, për të mbledhur taksa, sidomos në nivel Komunal, është ende i dobët. Aktualisht janë rreth 300 inspektorë tatimorë që merren me rreth 6048.00048,000 firma të regjistruara, pra me një raport 160:1. Evazioni i taksave konsiderohet të jetë shumë i madh (Autoriteti Tatimor i Kosovës vlerëson se shkalla e evazionit të taksave është rreth 50%). Një shkallë kaq e lartë e shmangies nga taksat është pasojë edhe e faktit se kompanitë bëjnë transakcionet e tyre në kesh (të gatshme) dhe nuk shkojnë përmes institucioneve financiare apo instrumenteve bankare. Për më tepër, shumica e firmave në Kosovë janë të organizuara si pronë vetanake ose si partneritete, që punësojnë më pak se 5 persona: gati 92% e ndërmarrjeve të regjistruara janë “biznese personale”, p.sh. biznese individuale që veprojnë kryesisht me ndihmën e anëtarëve të familjes, të cilët nuk paguhen.

14. — Një nga determinantet kryesore të ekonomisë informale është e lidhur me ritmin e zhvillimit ekonomik dhe me atë të shtimit të popullsisë. Sektorët të cilët që nga viti 1999 janë zhvilluar në Kosovë kanë qenë: ndërtimtaria, tregtia dhe shitja me pakicë dhe administrate publike. Sektori privat i paraqitur që nga 1999-ta është kryesisht i shkallës së ulët dhe me kapital të ulët. Përfundimi i hovit të rindërtimit të pasluftës ka çuar tek përqëndimi në sfidën e papunësisë dhe punësimit jo të plotë (ang. Underemployment) të popullatës së re me shtim të shpejtë. Krijimi i punësimit në tregun vendor

është i pamjaftueshëm për të absorbuar një rritje të tillë të ofertës së fuqisë punëtore. Në të kaluarën, problemi i shtimit rapid të popullsisë dhe papunësisë kronike zgjidhej përmes emigrimit mjaft të lartë, kryesisht në shtetet e Evropës Perëndimore. Emigrimi në këto shtete tani është shumë më i vështirë për shkak të politikave më të ashpra të emigrimit dhe Kosovarët, sidomos të rinjtë, kanë mbijetuar duke u punësuar në ekonominë informale.

15. ■ Faktorë tjerë që gjithashtu kontribuojnë në performancën e dobët ekonomike të Kosovës janë: i) procesi i privatizimit do të shkaktojë shkurtim të mëtejshëm të punësimit formal, ii) politikat e ngurta fiskale jo gjithmonë janë konsideruar si instrument për promovimin e rritjes së punësimit; iii) fakti se investimet vendore bazoheshin në aktivitete me vlerë të shtuar të ulët; dhe iv) ndjeshmëria e institucioneve ekonomike që ishin relativisht të reja dhe të papërvojë.

Instrumentet e mbrojtjes së fuqisë punëtore dhe aplikimi i tyre

16. ■ Shpesh thuhet se ndërmarrjet qëndrojnë në sektorin informal për shkak të i) shpenzimeve për regjistrim të një biznesi dhe kompleksitetit të procedurave administrative ii) shpenzimeve të zbatimit të ligjeve të punës. Këto informata të pakta se nëse shpenzimet për regjistrimin të biznesit në Kosovë dhe procedurat administrative kanë luajtur rol në vendimet për të punuar në ekonominë informale e jo në atë formale, edhe pse janë bërë një numër intervistash me të rinjtë e vetëpunësuar sugjerojnë se procedurat aktuale administrative vërtetë ndikojnë në këto vendime⁶. Sa i përket shpenzimeve për zbatimin e ligjeve të punës, analiza e bërë nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave ka zbuluar se legjislacioni aktual (shih katrorin 1 në vazhdim) është një ndër më fleksibël në Regjionin e EQL-së⁷. Është thënë se niveli i ngurtësisë së Legjislacionit të Mbrojtjes së Punësimit (LMP) kërkon më shumë vëmendje, edhe pse mbrojtja e punëtorëve nuk mund të kufizohet vetëm për ata që punojnë me kontratë pune⁸. Lidhur me këtë, nuk ka pasur ndonjë rast gjyqësor që do të ndriqonte nivelin e mbrojtjes së punëtorëve të ekonomisë informale.

⁶ Corbanese, V., Rosas, G., Tranzicioni i të rinjve drejt punës së përshtatshme: Dëshmi nga Kosova, op. cit.

⁷ Indeksi i Kushteve të Biznesit në Kosovë, USAID (2005).

⁸ Për metodologjinë dhe analizimin e efektit të LMP-së në rezultatet e kushteve të punës në shtetet e EQL-së shiko Cazes, S., Nesporova A., Tregjet e punës në tranzicion: Balansimi i fleksibilitetit dhe sigurisë në Evropën Qendrore dhe Lindore, kapitulli 5, ILO, Gjenevë, 2003.

Katrori 1

Pikat kryesore të Ligjit Themelor të Punës në Kosovë

Diskriminimi: Ndalohet diskriminimi në punësim dhe profesion (përfshirë dhe qasjen në aftësim profesional) bazuar në racë, gjini, ngjyrë, fe, moshë, status familjar, bindje politike, origjinë sociale, etj. Ligji Themelor i Punës në Kosovë obligon edhe për kompensim të barabartë për femra e meshkuj për punën e së njëjtës vlerë.

Mosha minimale për punë: 15 vjeçare. Të rinjtë në moshë ndërmjet 15 dhe 18 vjet mund të punojnë vetëm punë që nuk dëmtojnë shëndetin e tyre dhe që nuk ndikojnë në vijimin e shkollës.

Kontrata e punës: Ligji parasheh kontratë pune me shkrim. Kjo duhet të spjegojë natyrën, llojin dhe vendin e punës si dhe orarin e punës kohëzgjatjen, rrogën bazë dhe çdo obligim tjetër. Ligji siguron bazë edhe për shkëputje të kontratës nga ana e punëdhënësit.

Kushtet e punës: Orari i punës nuk bën të kalojë mbi 40 orë në javë (puna jashtë orarit nuk guxon të kalojë mbi 20 orë në javë dhe 40 orë në muaj), puna e natës është e rregulluar me ligj siç është rregulluar dhe e drejta për pushim vjetor, pushim të lehonisë, pushim mjekësor, etj. Punëdhënësi është i obliguar të marrë të gjitha masat e domosdoshme që të parandalojë aksidentet dhe sëmundjet në vendin e punës. Inspektorati i Punës është përgjegjës për monitorimin dhe implementimin e praktikave të shëndetit dhe sigurisë në punë.

Pensioni: punëdhënësi dhe punëtori kontribuojnë në Fondin Pensional me një shumë të barabartë prej 5% të pagës së përgjithshme.

Burimi: Regullorja 2001/27 mbi Ligjin Themelor të Punës në Kosovë (UNMIK/REG/2001/27) në <http://www.unmikonline.org/regulations/unmikgazette/02english/e2001regs/e2001regs.htm> (2005)

17. — Një faktor i madh që pengon krijimin e punës së përshtatshme në ekonominë informale është administrimi i punës. Shërbimet e inspektionit të punës kanë personel të pamjaftueshëm dhe janë të papajisura për të kontrolluar dhe promovuar zbatimin e ligjeve të punës në Kosovë. Poashtu, rregulloret që do të përforconin inspektorët e punës të lëshojnë ndëshkime apo gjopa për punëdhënësit që nuk respektojnë ligjet e punës. Për më tepër, ekzistonte nevoja për rifreskimin e njohurive dhe aftësive të inspektorëve të punës mbi sistemet dhe teknikat moderne të inspektionit të punës. Pjesëmarrësit u pajtuan mbi nevojën për rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të administratës së punës si dhe mbi intervenimet qeveritare në zbatimin e ligjit të punës. Në veçanti, shërbimi i inspektionit të punës duhet të lejohet të ndjekë penalisht rastet e shkeljes së të drejtave themelore të punëtorëve, dhe të ofrojë këshilla për punëdhënësit që të zbusin shkeljet e vogla.

Përmirësimi i të drejtave në ekonominë informale: veprimet e mundshme

18. ■ Gjatë tryezës së rumbullakët pjesëmarrësit thanë se mungesa e të dhënave mbi shkallën e ekonomisë informale është një nga pengesat kryesore që ka pamundësuar zhvillimin e masave adekuate për punëtorët në punë jot ë përshtatshme. Për të përmirësuar kushtet e punës të punëtorëve informal është e domosdoshme të identifikohen masat e tanishme ligjore, të vlerësohet zbatimi i këtyre masave (sidomos në nivel lokal) dhe të identifikohen rastet moszbatimi i ligjit të punës. Këto aktivitete mund të ndihmojnë në përmirësimin e zbatimit të legjislacionit ekzistues si dhe të rregullojnë realitetin e rid he të zgjidhin mospajtimet që kanë të bëjnë me rastet e punës të paparapara nga ligjvënësi.⁹

19. ■ Punëtorët e ekonomisë informale (sidomos ata të rinje), në masë të madhe nuk janë në dijeni rreth të drejtave të tyre në punë. Përgatitja dhe shpërndarja e materialeve mbi të drejtat ligjore të punëtorëve dhe dhënia e këshillave ligjore nga sindikatat mund të ndihmojnë në zbatimin e të drejtave në punë. Këto aktivitete duhet të theksojnë edhe përfitimet e punëdhënësve nga standardet e punës siç janë për shembull përmirësimi i performancës dhe produktivitetit të punëtorëve.

⁹ Kjo vlen, për shembull, për ato kontrata që, edhe pse janë të rregulluara me ligj civil, de-fakto dëmtojnë një marrëdhënie pune. Një shembull tipik i "kontratës civile" është marrëveshje ndërmjet një kompanie dhe një individi (paraprakisht "kontraktor") për të ndërmarrë detyra që koincidojnë me ato të një punonjësi të rregullt.

Konkluzionet dhe rekomandimet

20. — Sindikatat luajnë një rol të rëndësishëm në promovimin e mbrojtjes së të drejtave të punëtorëve informal. Janë dhënë disa propozime për tejkalimin e vështirësive të organizimit të këtyre punëtorëve, e ato janë i) rishikimi i strukturave të sindikatave për të lehtësuar apo mundësuar pjesëmarrjen e punëtorëve informal (e drejta e anëtarësimit dhe pjesëmarrjes, përfshirja në marrëveshje kolektive), ii) asistimi i punëtorëve informal që të krijojnë organizatat e tyre të anëtarësisë dhe iii) organizimi i shërbimeve të veçanta (informata, këshilla ligjore, trajnime mbi të drejtat e punëtorëve).

21. — Pjesëmarrësit erdhën në përfundim se është e domosdoshme të hartohet një strategji e integruar në mënyrë që të përfshihen dhe adresohen situatën aktuale të deficitit të punës së përshtatshme në të cilën hasin shumë punëtorë në Kosovë. Të kuptuarit e barrierave dhe vlerësimi i shpenzimeve të ndërmarrjeve për të vepruar në ekonominë informale në aspektin e regjistrimit, licensimit, taksatimit, zbatimit të rregulloreve të punës janë jetike për përmirësimin e ambientit të biznesit. U theksua se në shtetet e tranzicionit shpesh ka mungesë bashkëpunimi dhe koordinimi ndërmjet disa agjencive qeveritare. Përmirësimi i qeverisjes, i shoqëruar me dialog edhe më efektiv social, është tejet i rëndësishëm për hartimin dhe implementimin e strategjive që synojnë reduktimin e madhësisë së ekonomisë informale dhe mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve.

22. — Në tryezën e rumbullakët u arrit një pajtim i përgjithshëm që parimet fundamentale dhe të drejtat në punë duhet të vlejnjë për të gjithë punëtorët (e jo vetëm për ata në ekonominë formale). Ekzistonte nevoja për identifikimin e metodave të ndryshme për aplikim edhe tek punëtorët në ekonominë informale. Mungesa e të drejtave mund të vërehet nga mënyra se si këto të drejta janë të shprehura dhe zbatuara përmes ligjeve dhe praktikave nacionale si dhe nga mënyra se si punëtorët informalë i mund t'i kërkojnë dhe t'u respektohen të drejtat. Për këtë janë të domosdoshme njohja e administrimit dhe ligjeve të punës. Qeveria në konsultim me partnerët social mund të bëjnë një rishikim për të përcaktuar se si të dejtat ekzistuese në punë mund të shtrihen praktikisht dhe efektivisht edhe tek punëtorët në ekonominë informale.

23. — Poashtu është e rëndësishme dhe informimi i punëtorëve informal mbi të drejtat e tyre dhe mbi procedurat e kërkimit të të drejtave dhe mbi ato të kompensimit në rast se u mohohen ato. Lidhur me këtë, masa kryesore e identifikuar ishte organizimi i punëtorëve informal që t'u ipet zëri dhe përfaqësimi. Për shkak të natyrës jostabile të punës, punëtorët informal kanë qasje të kufizuar në drejtësi. Për më tepër, ata shpeshherë nuk mund të përballojnë shpenzimet për shërbime ligjore.

24. ■ Problemi i organizimit të punëtorëve informal është i ngjashëm me problemet që organizatat e punëdhënësve hasin për organizimin e ndërmarrjeve të vogla në ekonominë formale. Organizatat e punëdhënësve në mbarë botën gjithnjë e më shumë po e vërejnë se nuk mundën që në mënyrë efektive të promovojnë dhe mbrojnë interesat e ekonomisë formale pa rritur fushëveprimin e tyre edhe tek ndërmarrësit informal.

25. ■ Tryeza e rrumbullakët përmbylli procedimin e vet me katër rekomandime kryesore:

- i. Një ndër çështjet prioritare të Kosovës duhet të jenë të kuptuarit e shkallës së ekonomisë informale dhe mungesa e mundësive për punë të përshtatshme. Duhet bërë hulumtime për të kuptuar faktorët që formësojnë ekonominë informale si dhe efektin e mungesës së punës të përshtatshme. Analizimi i kornizës dhe praktikave ligjore që shpiejnë tek mbajtja e biznesit në ekonominë informale duhet të jenë fusha kryesore e hulumtimeve të tilla.*
- ii. Përmirësimi i qeverisjes fiskale dhe ekonomike si dhe i administrimit të punës;*
- iii. Rritja e ndërgjegjësimit mbi efektin negativ të ekonomisë informale në mirëqenien e punëtorëve, zhvillimin e ndërmarrjeve dhe në fitimet vendore (analiza e kosto-beneficioneve);*

dhe (për sindikatat)

- iv. Reformat, dhe rishikimi i strukturave dhe praktikave të tanishme për të identifikuar vështirësitë për përfaqësimin e punëtorëve informal, dhënia e zërit për punëtorët në ekonominë informale, mbështetja e vetëorganizimit të këtyre punëtorëve, përmirësimi i dialogut social dhe edukimi dhe informimi i punëtorëve mbi të drejtat e tyre në punë.*

Lista e Pjesëmarrësve

Annex I

1. Ali Dragusha, BSPK
2. Zeqir Shkodra, BSPK
3. Driton Qehaja, Zyra e Kryeministrit
4. Ylber Shabani, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
5. Shkumbin Demaliaj, Inspektorati i Punës
6. Gani Asllani, Ministria e Eekonomisë dhe Financave
7. Kadri Kryeziu, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
8. Melihate Termkolli, Ministria e Shërbimeve Publike
9. Haxhi Ramaj, Agjencioni për Regjistrim të Biznesit në Kosovë
10. Mustafë Hasani, Administrata Tatimore e Kosovës
11. Valli Corbaneze, Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO), Prishtinë
12. Anton Leppik, ICFTU
13. Sergejus Glovackas, ICFTU
14. Muhamet Sadiku, Riinvest
15. Mrika Kotorri, RiinvestRiinvest
1. Mustafë Hasani, Administrata Tatimore e Kosovës
16. Mustaf Ibrahimimi, OEK
17. Emine Ramosaj, OEK
1. Melihate Termkolli, Ministria e Shërbimeve Publike
18. Luan Gashi, USAID
19. Asociacioni i Komunave të Kosovës
1. Shkumbin Demaliaj, Inspektorati i Punës
20. Leonora Mushica, Dialogu Social
21. Haxhi Arifi, Sindikalist, BSPK
22. Alush Sejdiu, Sindikalist, BSPK
23. Miftar Hyseni, Sindikalist, BSPK
24. Qamil Berisha, Sindikalist, BSPK
25. Asllan Bajrami, Sindikalist, BSPK
26. Gani Xhigolli, Sindikalist, BSPK
27. Habib Basholli, Sindikalist, BSPK
28. Shukrije Rexhepi, Rrjeti I Grave, BSPK,
29. Arbnore Zogu, Rrjeti Rinor, BSPK
30. Naim Haliti, Zzyrtar Lligjor, BSPK

Programi

Annex II

Sesioni 1

- 09:00 - 09:45 Regjistrimi i pjesëmarrësve
- 09:45 - 10:00 Fjala hyrëse
Ali Dragusha, BSPK
- 10:00 - 10:20 Ekonomia iInformale në Kosovë: Perspektiva e Sindikatave
Zeqir Shkodra, BSPK
- 10:20 - 10:40 Vështrim i përgjithshëm mbi politikat ekonomike e fiskale të Kosovës
Driton Qehaja, Zyra e Kryeministrit
- 10:40 - 11:00 Korniza për mbrojtje të punës dhe mangësitë e implementimit:
roli i Shërbimeve të Inspektimit të Punës
Ylber Shabani, MPMS
Shkumbin Demaliaj, MPMS
- 11:00 - 11:20 Efekti ekonomik dhe financiar i ekonomisë informale në
zhvillimin e Kosovës
Gani Asllani, MEF
- 11:20 - 11:40 Determinantet e ekonomisë informale në Kosovë dhe të dhënat
e fundit mbi bizneset formale
Kadri Kryeziu, MTI
Haxhi Ramaj, AKRB
- Diskutime*
- Pauza*

Sesioni 2

- Coffee break Ekonomia infromale, punësimi informal dhe kushtet e
përshtatshme të punës
Valli Corbanese,Projekti I ILO-s për Punësimin e të Rinjëve
- 12:15 - 12:30 Trendet e Ekonomisë Informale në Evropën Jug-Lindore dhe
Qendrore: strategjitë dhe praktikat më të mira të sindikatave
Sergejus Glovackas, ICFTU
Anton Leppik, ICFTU
- 12:30 - 12:45 Strategjitë për konfrontimin e ekonomisë informale në Kosovë
Muhamet Sadiku, RIINVEST
Mrika Kotorri, RIINVEST

- 12:45 - 12:30 A janë regjimi i taksave dhe politikat fiskale të Kosovës të favorshme për zhvillim të biznesit?
Mustaf Hasani, Administrata Tatimore e Kosovës
- 12:30 - 12:45 Strategjitë e organizatave të punëdhënësve drejt ndërmarrjeve informale
Mustaf Ibrahim, OEK
- 12:45 - 13:00 Roli i qeverisjes së mirë dhe administratës publike në kufizimin e shkallës së ekonomisë informale
Melihate Termkolli, MSHP
- Sesion i Pyetje-përgjigjeve*
- Dreka*

Sesioni 3

- 14:30 - 15:30 Diskutime dhe rekomandimet
Luan Gashi, USAID
Valli Corbanese, ILO
Sergejus Glovackas, ICFTU
Anton Leppik, ICFTU
Muhemet Sadiku, Riinvest
Mustaf Ibrahim, OEK
Zeqir Shkodra, BSPK
- 15:30 - 16:00 Përmbyllja
Ali Dragusha, BSPK

Sindikatat dhe Sektori Informal: Drejt një Strategjie Gjithëpërfshirëse¹⁰

Në shumicën e vendeve në zhvillim e në tranzicion sektori informal është i gjërë, heterogjen në aspektin e aktiviteteve dhe profesioneve, dhe është sektor që rritet shumë shpejt. Ndonjëherë ai karakterizohet si inovativ, dinamik dhe ofrues i mundësive për njerëz me shpirt ndërmarrësi. Por, kushtet e punës në këtë sektor shpesh janë të pasigurta; pagat e punëtorëve dhe të të vetëpunësuarve shpesh të parregulluara dhe të ulëta; qasja në mbrojtje sociale, trajnim dhe shërbime sociale e kufizuar; shfrytëzimi dhe cënimi i të drejtave të punëtorëve është fenomen i zakonshëm. Për një shumicë të madhe të vartësve dhe të vetëpunësuarve, sektori informal nuk është hap i parë drejt avansimit, por është thjeshtë strategji e të mbijetuarit.

Shprehja “sektor informal” rrjedh nga Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO). Kjo, për herë të parë është përdorë në raportet e përgatitura nën Programin Botëror të Punësimit në fillim të viteve 1970-ta. Një nga konkluzionet e theksuara në këto raporte ishte se problemi kryesor social nuk ishte papunësia por ekzistimi i një popullate të madhe “të të varfërve të punësuar”, të cilët luftonin për të prodhuar mallra e shërbime por të cilëve, aktivitetet nuk u pranoheshin dhe as që u regjistroheshin apo mbroheshin nga autoritetet publike.

Që nga atëherë, termi “sektor informal” është përdorur për të mbuluar një sërë karakteristikash që janë specifike për “sektorin jomodern” urban të ekonomive në zhvillim dhe të tranzicionit. I definuar kështu, nocioni “sektor informal” mbulon atë pjesë të aktiviteteve të vogla të gjenerimit të të ardhurave që bëhen jashtë kornizave zyrtare rregullative dhe ku shfrytëzohet nivel i ulët i kapitalit, teknologjisë dhe aftësive, dhe të cilat sjellin të ardhura të ulëta dhe punësim jostabil.

Koncepti i dhënë nga ILO-ja për qëllime statistikore i referohet sektorit informal në këtë mënyrë:

... përbëhet nga njësi të angazhuara në prodhim të mallrave ose shërbimeve me objektiv primar gjenerimin e punësimit dhe të ardhurave të personave të përfshirë. Këto njësi zakonisht punojnë me një nivel të ulët organizimi, ku nuk ekziston ndarja ndërmjet fuqisë punëtore dhe kapitalit si faktorë të prodhimit. Marrëdhëniet e punës aty ku ekzistojnë bazohen kryesisht në punësim sipas

¹⁰ Kjo përmbledhje e dokumentit të ILO-s (1999), Sindikatat dhe Sektori Informal, Drejt një Strategjie Gjithëpërfshirëse, është përgatitur për Tryezën e Rrumbullakët mbi ekonominë informale të organizuar nga bashkimi I Sindikatave të Pavarura të Kosovës (19 Tetor 2005) që të shërbejë si bazë për diskutim.

nevojës, në njohtësi dhe marrëdhënie personale dhe në raporte shoqërore e jo në aranzhime të kontraktara me garancione formale. Njësitë prodhuese të sektorit informal kanë veçori të ndërmarrjeve familjare. Asetet fikse dhe tjera të shfrytëzuara nuk u takojnë njësitë të prodhimit por pronarëve të tyre... Shpenzimet për prodhim shpesh janë të pandashme nga shpenzimet familjare...

Aktivitetet e performuara nga njësitë e prodhimit të sektorit informal nuk bëhen domosdoshmërisht me qëllim të ikjes nga tatimet apo nga kontributet e sigurimit social, ose për shkak të ligjeve të ndërlikuara të punës a ligjeve tjera, ose masave administrative. Dhe në bazë të kësaj, koncepti i aktiviteteve të sektorit informal duhet të dallohet nga koncepti i aktiviteteve të ekonomisë së fshehur apo ekonomisë ilegale. Ky definicion bën dallim ndërmjet atyre aktiviteteve, të cilat si rezultat i pagave të ulëta që gjenerojnë, nuk mund të përballen me shpenzime të legalitetit dhe të cilat, pavarësisht se janë profitabile, qëllimisht nuk zbatojnë rregulloret, për arsye të shmangies nga taksat apo nga ligjet vendore. Për ILO-n, këto të fundit nuk janë të përfshira në sektorin informal, përderisa nuk përcillen përgjithësisht me strategji të mbijetuarit për të varfërit. Për të njëjtën arsye, termi “sektor informal” nuk duhet të përdoret për të përfshirë aktivitete kriminale dhe të padëshiruara nga aspekti social, siç janë për shembull, trafikimi me drogë apo prostitucioni.

Posedimi i njohurive mbi madhësinë dhe fushëveprimin e sektorit informal është parakusht për sindikatat të cilat dëshirojnë të hartojnë politika dhe strategji gjithëpërfshirëse lidhur me të njëjtin sektor. Heterogjeniteti i aktiviteteve informale, mobiliteti i fuqisë punëtore, variacionet sezonale dhe mungesa e sistemeve për mbledhje të të dhënave në shumicën e vendeve janë disa nga faktorët që shpjegojnë “padukshmërinë” e sektorit informal në statistikat zyrtare.

Ekonomia informale jep kontribut domethënës në prodhim dhe punësim. Rrjedhimisht, eliminimi i sektorit informal pa rritje dramatike të madhësisë së ekonomisë formale vetëm sa do të zmadhonte problemet e papunësisë dhe varfërisë në këto vende. Sektorët informalë ku punësohen një numër i madh punëtorësh kryesisht janë tregtia, bujqësia, ndërtimtaria, prodhimtaria, transporti dhe shërbimet me fjalë tjera, pothuaj çdo sektor. Gati të gjitha zanatet dhe shumica e profesioneve janë prezente në sektorin informal: floktarët, këmbimorët, instaluesit e ujit dhe mekanikët, mbledhësit e mbeturinave, shitësit e pemëve-perimeve, punëtorët e kioskave, rrobaqepësit, orëtarët, zdrukhtarët, ndihmësit shtëpiakë, etj.

Fuqia punëtore e sektorit informal përgjithësisht grupohet në tri segmente kryesore: pronarët apo punëtorët e mikro-ndërmarrjeve, të vetëpunësuarit

dhe punëtorët vartës. Segemnti i parë korrespondon me pronarët apo punonjësit e mikro-ndërmarrjeve të cilët punësojnë disa punëtorë. Ata në përgjithësi nuk përbëjnë grupin në fokus për hartimin e politikave nga sindikatat. Mirëpo, ata mund të përfaqësojnë një partner potencial negociimi pasi që janë direkt apo indirekt të angazhuar në marrëdhënie pune me shumë punëtorë të sektorit informal të cilët sindikatat mund të tentojnë t'i përfaqësojnë.

Segmenti i dytë përbëhet nga të vetëpunësuarit, që punojnë vetë apo me punëtorë pa pagesë. Ky është segmenti më i madh i sektorit informal.

Segmenti i tretë përfshin punëtorët vartës, të angazhuar në punësim me orar të plotë apo vetëm sipas nevojës. Këtu përfshihen punëtorët me page, të angazhuar në mikro-ndërmarrje, përgjithësisht pa kontratë formale dhe që

Në shumë mënyra, problemet e punëtorëve të ekonomisë informale janë ngushtazi të lidhura me statusin e tyre të punësimit. Për shembull, problemet me të cilat përballet një shitës ambulant dallojnë shumë me ato të një punëtori nga shtëpia. Brenda të të njëjtit grup punëtorësh, dallon edhe pozita e meshkujve krahasuar me atë të femrave. Pavarësisht këtyre dallimeve, pasiguria dhe lëndueshmëria vlejnë si për të vetëpunësuarit ashtu dhe për punëtorët vartës të ekonomisë informale përderisa ata punojnë jashtë fushëveprimit të mbrojtjes ligjore dhe sociale.

Të vetëpunësuarit krijojnë biznesin e tyre të një personi. Ata punojnë vetë apo me punëtorë pa pagesë, kryesisht anëtarë të familjes. Efikasiteti i aktiviteteve të tyre shpesh pengohet për shkak të mungesës së kredive për investime të vogla, aftësive teknike për të kryer aktivitetet, lëndës së parë dhe qasjes në furnizim me ujë e rrymë. Ata kryesisht nuk kanë qasje në kredira të institucioneve huadhënëse për shkak se nuk mund të ofrojnë siguri të mjaftueshme ekonomike, dhe shpeshherë marrin hua në shumta të cilat nuk mbulojnë as shpenzimet administrative të huadhënies. Ata kryesisht nuk mund të përballojnë pagesat e caktuara nga institucionet zyrtare të trajnimit, dhe kurset e ofruara nga këta të fundit jodomsdoshmërisht janë të adaptuara karshi nevojave elementare të tyre. Vendet e punës shpesh janë të pashëndetshme dhe pasigurta dhe ndonjëherë të vendosura në lokacione që nuk tërheqin blerësit e mundshëm. Situata e **të vetëpunësuarve në zonat rurale** meriton vëmendje të veçantë, për shkak të hises së madhe të fuqisë së punës në bujqësi në gjithë popullatën aktive ekonomike. Reduktimi i barrierave tregtare dhe reformat e tjera të pasuara me ristrukturimin e ekonomisë botërore kanë rezultuar me ulje të pagave në punësimin e bujqësisë. Si pasojë, dallimi ndërmjet punëtorëve ruralë me pagë krahasuar me popullatën tjetër të punësuar bëhet më pak li qartë, ku të gjithë të punësuarit në bujqësi përballen me vështirësi të ngjashme.

— **Shitësit ambulantë** paraqesin një përqindje të konsiderueshme të fuqisë punëtore në ekonominë informale. Këta shitës janë sigurisht komponenta më “e dukshme” e sektorit informal dhe luajnë një rol shumë të rëndësishëm në furnizimin me mallra dhe shërbime për familje me të ardhura të vogla e të mesme. Për shkak të lokacionit publik ku ata veprojnë, mallrat e tyre mund të shkatërrohen, vidhen apo konfiskohen fare lehtë. Qasja në hapësirë dhe në shërbime si ujë, rrymë, etj. janë problemet kryesore të tyre.

— **Punëtorët me pagesë** në mikro-ndërmarrje shpesh përballen me kushte të vështira dhe pasigurta pune dhe përgjithësisht nuk kanë qasje në shumë beneficione siç kanë punëtorët e sektorit formal, e ato janë pagesa për punë jashtë orarit, pensionet e moshës së vjetër, sigurimi shëndetësor dhe invalidor, orari i caktuar i punës, pushimi vjetor i paguar, mbrojtja e lehonisë, etj. Ata kanë fare pak fuqi të marrëdhënieve industriale, zakonisht janë të panjohur (të papranuar) dhe kushtet e punës si dhe pagat e tyre vendosen unilateralisht nga pronari i mikrondërmarrjes. Ata mund të angazhohen në baza të rregullta apo të kohëpaskohshme. Në rastin e kësaj të fundit, ata kanë siguri të kufizuar të punësimit.

— **Punëtorët pa pagesë** janë kryesisht anëtarë të familjes dhe qirakë. Gratë dhe fëmijët paraqesin një përqindje domethënëse të këtyre punëtorëve. Ky lloj punësimi nuk është domosdoshmërisht i regjistruar në statistika dhe shpesh është pa pagesë si pasojë e traditave kulturore. Puna pa pagesë është më e shtrirë në zona rurale.

— Punëtorët e angazhuar si **punëtorë të kontraktuar në sektorin informal** janë shpesh në fund të zingjirit të dukshëm të nënkontraktuesve. Përveç se përballen me probleme të punëtorëve të paguar, ata veprojnë në kushte që u mundësojnë punëdhënësve të evitojnë përgjegjësinë ligjore për kontrollim të kushteve të punës. Kjo ndikon drejtpërdrejt në kushtet e shëndetit dhe sigurisë së tyre në punë, përfshirë edhe rreziqet për shkak të ekspozimit ndaj substancave kimike, apo peshave të rënda dhe teknologjisë.

— **Punëtorët nga shtëpia** janë ndër grupet më të “padukshme” të sektorit informal. Numri total i punëtortëve në këtë grup sigurisht se mbetet i nënçmuar. Mirëpo, të dhënat anekdotike tregojnë se puna nga shtëpia po rritet në gjithë botën. Puna nga shtëpia, e definuar sipas Konventës së ILO-s, 1996 (Nr. 177) mbi Punën nga Shtëpia, i referohet punës së bërë nga një person, për kompensim (pagesë) në shtëpinë e tij ose saj apo në ndonjë objekt sipas dëshirës së tij/saj, e jo në vendin e punës tek punëdhënësi, e cila rezulton me një produkt ose shërbim të specifikuar nga punëdhënësi, pavarësisht asaj se kush i siguron paisjet, materialet apo inputet tjera të shfrytëzuara. Në përgjithësi, punëtorët nga shtëpia nuk janë të mbuluar nga ligjet nacionale të punës. Shumica e punëtorëve nga shtëpia punojnë në bazë të marrëveshjes gojore prandaj statusi i tyre i punësimit nuk regjistrohet dhe

punëdhënësi i tyre fshihet prapa disa niveleve të nënkontraktuesve. Kjo i pengon ata të kenë qasje në sigurim social.

Klasifikimi i mësipërm i punëtorëve të sektorit informal nuk reflekton në mënyrë adekuate kompleksitetin e këtij sektori. Në botën e vërtetë, nuk ekzistojnë kufij të qartë ndërmjet segmenteve të mësipërme dhe ekziston mobilitet konstant i punëtorëve ndërmjet kategorive të ndryshme të punësimit dhe madje dhe ndërmjet profesioneve, varësisht nga koha e vitit, situata ekonomike dhe kërkesat e strategjive të tyre të mbijetuarit.

Qëndrimet dhe politikat e qeverisë karshi sektorit informal do të ndikojnë shumë në madhësinë dhe kualitetin e punësimit në këtë sektor por do të ndikojnë edhe që të vetëpunësuarit, punëtorët vartës dhe mikrondërmarrjet e sektorit informal të kalojnë në komponente tjera të ekonomisë. Politikat qeveritare drejt sektorit informal dallojnë nga shteti në shtet dhe kanë evoluar me kalimin e kohës krahas ndryshimit të perspektivave politike mbi teorinë e zhvillimit ekonomik. Roli i Shtetit është tejet i rëndësishëm që të diskutojë çdo politike që ka të bëjë me sektorin informal me sindikatat. Është esenciale që sindikatat të hartojnë dhe promovojnë një këndvështrim koherent lidhur me atë se çfarë politika ekonomike, ligjore dhe administrative duhet adaptuar në raport me sektorin informal.

Gjatë fundit të viteve 1970 dhe 1980 në shumicën e shteteve në zhvillim dhe ato të industrializuara zhvillimi ekonomik ishte joekzistent ose i pamjaftueshëm për të absorbuar popullatën në rritje; dhe krijimi i vendeve të punës ishte tepër i ngadalshëm për të parandaluar eksplodimin e papunësisë apo të punësimit të pamjaftueshëm (underemployment). Për ata që kishin fat të kenë punë të rregullt, të ardhurat e tyre u zvogëluan, kushtet e punës u përkeqësuan dhe siguria e punësimit u zhduk. Për të tjerët, alternativë e vetme ishte të luftohet për mbijetesë në sektorin informal. Kontributi që sektori informal ka dhënë për mbijetesën e miliarda punëtorëve është i pamohueshëm, dhe dihet se në disa komponenta të sektorit informal ekziston shpirt i konsiderueshëm ndërmarrës dhe potencial kreativiteti. Shumë shpesh, sistemet reciproke të asistimit paraqiten në sektorë të cilët u mundësojnë punëtorëve të përballen me probleme dhe të krijojnë mundësi të reja. Rrjetet e vetëasistimit dhe të vetëfinancimit krijohen në sektorin informal dhe atë bazuar në lidhje familjare apo tek miqtë. Me pak fjalë, punëtorët e sektorit informal zakonisht janë inovativë, dinamikë dhe fleksibilë por të varfër.

Poashtu dihet se kualiteti i punës, standardi i jetesës dhe shkalla e shfrytëzimit të punëtorëve në sektorin informal është e papranueshme. Rrjedhimisht, të punuarit në sektorin informal është pak më shumë se strategji e të mbijetuarit apo është zgjedhja e dytë më e mirë për shumicën e njerëzve që punojnë në atë sektor. Përveç kësaj, shumica e njerëzve do të

thonin se më mirë është të fitohet pak se të mos fitohet fare, dhe më mirë është të punosh kudoqoftë se të mos punosh fare. Pavarësisht brengave të mëdha për mirëqenien e punëtorëve të sektorit informal, sindikatat do të pajtoheshin me këto teori, mirëpo gjithsesi duke punuar drejt nxitjes së politikave publike për përmirësimin e pozitës së punëtorëve të sektorit informal dhe për t'i integruar ata në sektorin formal.

Duke ditur se sektori informal mund të kontribuojë shumë në strategjinë e të mbijetuarit për punëtorët jashtë sektorit formal dhe duke tentuar që të zvogëlohet eksploatimi i punëtorëve, janë bërë shumë përpjekje që të arrihet njëfarë balansi ndërmjet këtyre dyjave. Për shembull, Rekomandimet për Politikat e Punësimit të ILO-s (Masa Plotësuese), e vitit 1984 (Nr. 169), ILO fton Shtetet anëtare të njohin rëndësinë e sektorit informal si burim i vendeve të punës përderisa të vazhdojnë pandërprerë “të krijojnë masa për rregullimin e sektorit informal”, edhe pse duhet marrë parasysh faktin se integrimi i sektorit informal mund të zvogëlojë kapacitetin e tij për të absorbuar fuqi punëtore dhe për të gjeneruar të ardhura, së paku për një periudhë afatshkurtër.

Mirëpo, kjo strategji e formalizimit gradual thjeshtë nuk po funksionon. Përderisa politikat dhe programet e hartuara për asistimin e ndërmarrjeve të vogla në përgjithësi adresojnë problemet e ndërmarrësve për qasje në tregje, kredi, ekspertizë teknike, teknologji të avansuar dhe aftësi menaxheriale, përmirësimi i kushteve të punës në ndërmarrje lihet si çështje e dorës së dytë. Arsyetimi për këtë fenomen është se me zhvillimin e ndërmarrjeve, do të përmirësoheshin automatikisht kushtet e punëtorëve. Kjo bindje bazohet në teorinë e “zmadhimit” (ang. “trickle down”) të zhvillimit ekonomik e social që është dëshmuar të jetë jorealiste.

Sipas kësaj linje të të menduarit, në vend se të tentojnë të kufizojnë apo rregullojnë sektorin informal, qeveritë duhet të koncentrohen në krijimin e një ambienti të favorshëm për të. Ka pasur fjalë se shpenzimet e larta dhe koha e nevojshme për regjistrimin e një biznesi, kompleksiteti i procedurave administrative dhe papërshtatshëmria e rregulloreve drejt përmbushjes së nevojave të sektorit informal kanë vepruar si pengesa dhe kanë dekurajuar ndërmarrësit që të legalizojnë aktivitetet e tyre. Në qendër të kritikave ishin shpenzimet e larta për zbatimin e ligjeve të punës, dhe kjo ka rezultuar me mbetjen e firmave në sektorin informal. Për më tepër, për ndërmarrjet e sektorit formal thuhej se shpenzimet e larta për fuqinë punëtore do të nxitnin ndërmarrësit të reduktojnë numrin e punëtorëve dhe të bëjnë zëvendësimin e tyre me paisje kapitale.

Përgjigja ishte se duhet larguar barrierat ndërmjet sektorëve formal dhe informal përmes eliminimit apo reformimit të një sërë rregulloresh në lëmi si ligjet e punës, pagat minimale, sigurimi social, shëndeti dhe siguria në vende

të punës, tatimet si dhe rregulloret që kanë të bëjnë me regjistrimin dhe administrimin e një ndërmarrjeje. Proklamuesit e kësaj teorie thonin se këto iniciativa do të lironin iniciativën private dhe potencialin ekonomik të të vetëpunësuarve dhe mikrondërmarrjeve të sektorit informal.

Këto politika karshi sektorit informal ishin pjesë e një qasjeje më të gjërë laissez-faire drejt politikave ekonomike të të 1980-ave dhe të 1990-ave. Në këtë periudhë theksi i politikave ekonomike u ngushtua nga zhvillimi në masë të gjërë, punësimi i plotë dhe nivelet e larta të të ardhurave drejt luftimit të inflacionit, nxitjes së investimeve private dhe promovimit të forcës së tregut me çdo mjet.

Arsyetimi për këtë pako politikash ishte besimi se të gjitha intervenimet qeveritare ishin të këqija: se qeveritë nuk mund të japin kontribut pozitiv për vende të punës dhe zhvillim, dhe se ekonomia duhet të lihet plotësisht në duar të forcave të tregut.

Rezultatet e këtyre politikave ishin të dëmshme për shumicën e shteteve. Zhvillimi i premtuar ekonomik përmes rritjes së eksportit dështoi të materializohet në shumicën e vendeve, papunësia dhe punësimi i pamjaftueshëm pësuan rritje, ndërsa qasja në shërbime shëndetësore, arsimore dhe sociale u vështirësua dukshëm. Mirëpo në të njëjtën kohë, u theksuan dhe më shumë dallimet në paga, qasja në punë dhe kualiteti i vendeve të punës, si brenda vetë shteteve ashtu dhe ndërmjet shteteve.

Në shumicën e shteteve sindikatat kundërshtuan qëllimet e këtyre politikave për shkak të ndikimit të dëmshëm të tyre social dhe dështimit për të përmbushur beneficionet e premtuara në aspektin ekonomik dhe në atë të rritjes së punësimit. Lëvizja sindikaliste ndërkombëtare vazhdimisht kishte theksuar disa probleme fundamentale lidhur me kohën, porositjen dhe paketimin e politikave të stabilizimit dhe përshtatjeve strukturore. Sindikatat theksuan se politikat duhet të “qepen” më shumë në bazë të nevojave të një vendi; se komponenta e stabilizimit ishte shumë e ngurtë dhe se ndryshimet strukturore duhet të shpërndahen për një periudhë më të gjatë kohore dhe të jenë rezultat i dialogut trepalësh.

Në ekonomitë me zhvillim të ulët, të karakterizuara me mungesë të infrastrukturës themelore, dhe me tregje dhe ndërmarrës të pazhvilluara, dhe ku prodhuesit kanë njohuri të kufizuara të teknologjisë prodhuese dhe mundësive në treg, do të ishte joreale të pritej që oferta të përgjigjej automatikisht ndaj përshtatjes së çmimeve. Prandaj, sindikatat vazhdimisht kanë pohuar se është e rëndësishme të arrihet një përmirësim në balansin tregtar përmes pasurimit të strukturës eksportuese e jo vetëm përmes rritjes së shitjeve të produkteve primare.

Është evidente se përgjigja e avokuar nga sindikatat lidhur me programet e përshtatjeve strukturore dhe me problemet ekonomike të shteteve në zhvillim ishte, dhe mbetet, plotësisht jokonsistente me nocionin më të thjeshtë se zhvillimi dhe prosperiteti ekonomik mund të gjenerohet në mënyrë rapide përmes largimit të kontrollit administrativ, ligjor dhe taksor mbi industrinë dhe sektorin informal. Këmbdështrimi i sindikatave ishte se forcat e papenguara të tregut nuk janë ilaq për të gjitha format e problemeve ekonomike dhe se Shteti duhet të luajë një rol fundamental në përmirësimin e dështimeve të tregut dhe në nxitjen e zhvillimit ekonomik përmes investimeve në infrastrukturë, zhvillim të resurseve njerëzore dhe kapitale dhe qasjes në kredi.

Për më tepër, respektimi i të drejtave të punëtorëve duhet të jetë objektiv dhe mjet për arritjen e objektivave tjera të politikave sociale. Këto të drejta janë objektiv sepse ato janë pjesë e rëndësishme e të drejtave të njeriut në përgjithësi, dhe respektimi i tyre në këtë rast është domosdoshmëri morale. Kjo rrjedh nga fakti se këto janë kushte mundësuese pa të cilat punëtorët nuk mund të ushtrojnë fuqinë e tyre për të arritur përmirësimin e kushteve të punës. Për më tepër, si shtyllë kyçe e demokracisë politike, liria e të shprehurit dhe e organizimit janë poashtu esenciale për të siguruar që politikat ekonomike e sociale të avansojnë dhe më shumë drejtësinë sociale.

Përveç këtyre standardeve ndërkombëtare të punës, ekzistojnë dhe një sërë instrumentesh të ILO-s të cilat synojnë të ofrojnë udhëzime praktike për Shtetet anëtare drejt ndjekjes së kushteve të përshtatshme dhe të sigurta të punës, eliminimit të varfërisë dhe pasigurisë së të ardhurave dhe për të arritur punësim të plotë dhe rritje të standardit jetësor.

Legjislacioni i punës është instrument esencial që u siguron punëtorëve të drejtat dhe mbrojtjen e domosdoshme dhe kushte të pranueshme të punësimit. Kjo mund të ndahet në dy komponente. E para, ekzistojnë të drejtat themelore të njeriut si liria e organizimit dhe barazia. E dyta, zakonisht ekzistojnë rregulla themelore për trajtim të barabartë në çështje si siguria e vendit të punës, mandej rregullat procedurale që kanë të bëjnë me marrëdhëniet kolektive ndërmjet sindikatave dhe punëdhënësve, si dhe standardet bazike minimale mbi çështje plotësuese si kushtet e punës, shëndeti dhe siguria, grupet e lëndueshme dhe siguria e të ardhurave.

Një spjegim rreth mohimit të të drejtave dhe mbrojtjes sociale të punëtorëve të sektorit informal duhet të gjendet në legjislacionin e punës, ku së pari duhet të identifikohet natyra e marrëdhënieve të punësimit që ekzistojnë në sektorin informal. Një përqindje e madhe e punëtorëve të sektorit informal janë të vetëpunësuar. Për dallim nga shumica e standardeve të punës që synojnë të aplikohen për të gjithë “punëtorët”, legjislacionet e punës në shumicën e shteteve janë të krijuara të mbrojnë “të punësuarit”. Përkufizimi

ligjor i një të “punësuar” është çështje komplekse, por në shumë shtete, të vetëpunësuarve apo punëtorëve me kontratë u mohohen të drejtat dhe mbrojtja që aplikohet për statusin e të punësuarit.

Ligjet tradicionale të punës bazohen në premisën e ekzistimit të një marrëdhënieje pune e dëshmuar me kontratë të punësimit sipas së cilës i punëtori i ofron punëdhënësit punën për të cilën do të paguhet apo kompensohet. Zakonisht, punëdhënësi ushtron kontroll mbi mënyrën e performimit të funksioneve, lokacionin e punës, orarin e punës, ditët e punës etj. shumë nga këto karakteristika mungojnë në marrëdhëniet e punës të sektorit informal. Për kategoritë tjera të punëtorëve të sektorit informal, që nuk janë të vetëpunësuar, zbatimi i ligjeve të punës duhet të jetë më pak kundërtënë. Për shembull, punëtorët me pagë në mikrondërmarrje të sektorit informal duhet patjetër të jenë në kuadër të fushëveprimit të ligjeve të punës. Por, në realitet, shumica e punëdhënësve në sektorin informal nuk u sigurojnë punëtorëve të gjitha masat e ligjeve të punës. Studimet e ILO-s zbulojnë se beneficionet si pushimi me pagesë, pushimi mjekësor dhe kompensimi i punës jashtë orarit shpesh nuk u ipen këtyre punëtorëve.

Hulumtimet e ILO-s poashtu tregojnë se shumë punëtorë të sektorit informal konsiderojnë se ligjet e punës janë jorelevante për gjendjen e tyre dhe se ata nuk, apo nuk duhet të gëzojnë mbrojtjen dhe beneficionet e siguruar me ligj. Ky zbulim sugjeron që qeveritë dhe sindikatat të përkushtohen më shumë për tejkalimin e problemeve duke filluar nga mosdija e të drejtave të siguruar me ligjet e punës. Ata poashtu do mund të organizonin fushata më sistematike për të ndryshuar perceptimin negativ të ligjeve dhe rregulloreve të punës. Pasi që punëdhënësit këto i shohin si barrë, theksi duhet të vihet në beneficionet nga zbatimi i tyre, sidomos përsa i përket performancës së punëtorëve dhe produktivitetit të kompanive.

Në dhjetëvjetshin e fundit shumë sindikata nacionale kanë filluar të rikontrollojnë dhe reformojnë perceptimet dhe politikat e tyre mbi sektorin informal. Disa qendra haptazi kanë pranuar se në të kaluarën kanë adaptuar një qëndrim thjeshtë negativ të këtij sektori dhe se tash e njohin dhe e dinë se nevojiten disa ndryshime domethënëse.

Janë disa arsye që kanë shtyrë qendrat nacionale të sindikatave të mbeten skeptike lidhur me sektorin informal. Së pari, mendohet se ky sektor është fenomen tranzitor dhe me kalimin e kohës do të absorbohet nga sektori formal pa pasur nevojë për veprime nga sindikatat apo nga vetë Shteti. Kjo bindje ka qenë dhe ende është shumë e pranuar. Mirëpo, fatkeqësisht, nuk duket të jetë realiste. Në vend se të zvogëlohet, sektori informal është në rritje ndërsa sektori formal po dobësohet për shkak të kontraktimit të shumë aktiviteteve të tij. Duhet të dihet se sektori informal është element i pandashëm i tregut të punës dhe se pa veprime të koordinuara nga sindikatat dhe pa ndryshime të mëdha të politikave të qeverisë, as nuk do të humbet e

as nuk do të absorbohet nga sektori formal. Për më tepër, edhe poqese do të ekzistonin politika qeveritare për implementim të premtimeve që janë dhënë lidhur me integrimin, as atëherë kjo nuk do të arrihej shpejt.

Së dyti, sindikatat hasin në vështirësi të mëdha për të mbajtur dhe mobilizuar anëtarët e tyre në pjesën formale të ekonomisë dhe mendojnë se nuk janë në pozitë të shfrytëzojnë resurset edhe ashtu të mangëta për sektorin informal. Shumë sindikata konsiderojnë se ky nuk do ishte shfrytëzim efikas i resurseve njerëzore e financiare të lëvizjes sindikaliste. Shpesh ka dhe arsye pragmatike për këtë, përfshirë edhe natyrën heterogjene të marrëdhënieve të punësimit, vështirësitë për gjetjen dhe kontaktimin e punëtorëve të sektorit informal dhe pengesat për t'u organizuar në sektorin formal të krijuar nga Shteti. Veç kësaj, punëtorët e vetëpunësuar trajtohen si “ndërmarrës”, dhe kështu nuk janë anëtarë potencialë të sindikatave apo partnerë të përshtatshëm për bashkëpunim. Për shkak të këtyre kushteve, shumë sindikata në nivel nacional kanë vendosur të lënë plotësisht anash sektorin informal; apo deri në një masë që ata provojnë të koordinohen me apo të organizojnë sektorin informal, dhe angazhimi i tyre bëhet në baza ad-hoc, kështu që sektori nuk konsiderohet parësor.

Pavarësisht kësaj perspektive përgjithësisht pesimiste por ndoshta pragmatike rreth kthimeve që sindikatat presin nga investimet në sektorin informal, eksitojnë edhe qendra tjera nacionale sindikaliste dhe unione të nivelit të ulët që janë betuar për angazhim dhe kanë përkushtuar mjaft kohë dhe resurse për të organizuar dhe/ose ndërtuar ura ndërmjet lëvizjes formale të sindikatave dhe punëtorëve të sektorit informal.

Në shumë raste fokusi është vënë edhe në përmirësimin e gjendjes së të vetëpunësuarve dhe mikrondërmarrësve dhe/ose në përmirësimin e qasjes së tyre në shërbime specifike, si kredi, trajnim të aftësive menaxheriale, marketing dhe teknologji të reja, informata dhe këshillim mbi ligjet ekzistuese, zgjidhje të kontesteve dhe përkrahje arsimore.

Strategjitë e sindikatave lidhur me ekonominë informale

Sindikatat e nivelit nacional duhet të diskutojnë një sërë çështjesh për hartimin e një strategjie koherente dhe gjithëpërfshirëse për sektorin informal. Teorikisht, çdo strategji e tillë duhet të mbulojë një sërë çështjesh ekonomike, sociale dhe të marrëdhënieve industriale që përbëjnë sektorin, plus një rishqyrtim gjithëpërfshirës të proriteteve dhe strategjive të brendshme të sindikatës.

Politikat e jashtme

a) Standardet e punës dhe ligjet e punës

Ekzistojnë dëshmi të shumta se të drejtat themelore, që janë të reflektuara në standardet themelore ndërkombëtare të punës e që kanë të bëjnë me lirinë e organizimit, marrëveshjeve kolektive, diksriminimin, punës së detyruar dhe punës së fëmijëve, shpeshherë shkelen në mënyrë flagrante në sektorin informal.

Konventat dhe Rekomandimet më të rëndësishme të ILO-s nuk janë adaptuar në bazë të bindjes së ato të zbatohen për të gjithë “punëtorët”, pavarësisht sektorit, profesionit apo llojit të punës ku janë angazhuar ata. Deklarata e ILO-s e adaptuar tash së voni mbi Parimet dhe të drejtat themelore në Punë thekson se të gjitha qeveritë janë të obliguara të respektojnë, promovojnë dhe realizojnë principet e deklaruara në standardet bazë ndërkombëtare të punës. Është me rëndësi të thuhet se në këtë kontekst Deklarata nuk bën dallim ndërmjet ekonomive formale dhe informale. Përkundrazi, ajo deklaron se provizioni i këtyre parimeve dhe të drejtave fundamentale do t'u mundësojë të gjithë personave të kërkojnë hisen e tyre të pasurisë që e kanë krijuar me vite dhe për të arritur potencialin e plotë njerëzor të tyre.

Praktikisht, implementimi i deklaratës nënkupton që ligjet dhe praktikat e punës duhet reformuar në atë mënyrë që të sigurojnë:

— Që të gjithë punëtorët, përfshirë edhe ata të sektorit bujqësor, punëtorët pa pagesë, punëtorët sezonalë, të vetëpunësuarit dhe kategoritë tjera të punëtorëve të cilët përbëjnë sektorin informal, të kenë të drejta të njëjta të organizimit si ato të garantuara për punëtorët industrialë.

— Që sigurim adekuat të garantohet për të gjithë punëtorët, përfshirë edhe punëtorët nga shtëpia dhe grupet tjera të punëtorëve të sektorit

informal, dhe kundër akteve diskriminuese të kundër organizimit lidhur me punësimin e tyre.

— Që asnjë person të mos detyrohet të punojë nën presion, punë për të cilën personi nuk është ofruar vullnetarisht.

— Që personat nën moshën 15 vjeçare të mos punojnë. Në kontekstin e deklaratës kjo nënkupton që ndërmarrësit e sektorit informal duhet të përkrahin përpjekjet që fëmijët në punë të kalojnë në shkollim bazik.

— Konventa e ILO-s kundër Diskriminimit (në Punësim dhe Profesion), 1958 (Nr. 111) duhet të zbatohet. Në praktikë, sipas kësaj duhet ndihmuar sektorin informal në formë të aftësisimit profesional dhe kjo pa dallim në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, religjionit, bindjeve politike, prejardhjes nacionale dhe origjinës sociale.

— Parimet e kompensimit të njëjtë për punën e së njëjtës vlerës, sipas Konventës së ILO-s për Kompensim të Barabartë, 1951 (Nr.100) vlejné dhe për sektorin informal, dhe nga Shtetet janë ndërmarrë masa për të promovuar zbatimin e kësaj Konvente. Për shkak të përqindjes së madhe të punëtoreve femra në sektorin informal, kjo Konventë është e një rëndësie të veçantë. Në disa shtete mbrojtjet e siguruara nën ligjet e punës nuk vlejné për të punësuarit e sektorit informal të cilët nuk paguhen por kompensohen në forma tjera. Ligjet e punës ndonjëherë bëjnë dallim ndërmjet të punësuarve dhe “punëtorëve”, të cilat u garantojnë të drejta themelore të gjithë personave por më shumë beneficione specifike vetëm “të punësuarve”. Aty ku ekzistojnë këto dallime duket e udhës të rishikohen ligjet e punës që të sigurohet më shumë mbrojtje për të gjithë punëtorët, dhe, si maksimum, të sigurohet që çështjet si të drejtat fundamentale dhe mbrojtja e sigurisë në punë të zbatohen dhe të vlejné për të gjithë. Ligjet poashtu duhet të sigurojnë që të gjithë punëtorët të shpërblehen sipas orarit të punës, pushimeve, e kështu me rradhë.

Zbatimi i disa aspekteve të ligjeve të punës, si rregulloret e shëndetit dhe sigurisë, pagat minimale dhe orari i punës, ka tendencë të përmirësohet me rritjen e madhësisë së ndërmarrjeve dhe rritjen e jetëgjatësisë së tyre. Në anën tjetër, beneficionet si pushimi mjekësor me pagesë, kompensimi i punëtorit në rast aksidenti apo vdekjeje, pushimi vjetor dhe pushimi i lehonisë pothuaj se kurrë nuk sigurohen në sektorin informal, pavarësisht madhësisë dhe moshës së ndërmarrjes.

Këto pika kanë shtyrë shumë vëzhgues të sugjerojnë se standardet dhe ligjet e punës duhet të shtrihen edhe në sektorin informal gradualisht dhe në baza selektive. Me këtë ndoshta mendohet që t'i përkushtohet vëmendje standardeve themelore të punës fillimisht, e mëpastaj të tentohet zbatimi i ligjeve të pagës minimale, rregulloreve të shëndetit dhe sigurisë, e kështu me rradhë. Kjo qasje

sigurisht se është konsistente me konsensusin ndërkombëtar mbi standardet e punës që janë prezentuar gjatë disa viteve të fundit.

b) Promovimi i qeverisjes së mirë dhe administrimit të shëndoshë të punës

Pjesët e mëhershme të këtij dokumenti kanë vënë theks në rëndësinë ekonomike e sociale të ligjeve të mirëfillta të punës. Mirëpo, kjo nuk do të thotë se ligjet janë gjithmonë të përkryera ose se implementimi i rregulloreve do të shkojë pa probleme. Në fakt, një nga arsytet pse njëzëti në sektorin informal nuk i zbatojnë rregullat dhe rregulloret është perceptimi i tyre se këto janë vetëm shpenzime nga të cilat nuk përfitojnë asgjë. Prandaj, sindikatat mund të shqyrtojnë lobimin me qeveritë për të racionalizuar rregulloret e kushtueshme dhe të gjejnë mjete më pak të shtrenjta për të arritur objektivat e dëshiruara sociale. Për shembull lidhur me kërkesat e shëndetit dhe sigurisë, ndërmarrjeve të vogla mund t'u propozohen paisje alternative dhe më të lira e këto të përfshihen në legjislacion (për më shumë spjegime në vazhdim). Një tjetër problem i madh është mënyra e implementimit të rregulloreve dhe korrupsioni që shpesh shoqëron mbledhjen e taksave dhe zbatimin e rregulloreve. Kjo sigurisht që kontribuon në perceptimin e qeverisë si “të prishur” nga sektori privat dhe se të gjitha format e rregulloreve nuk janë asgjë tjetër përveçse barrë e paarsyeshme për ta. Në këso rrethana moralisht bëhet legjitime, dhe përgjithësisht e pranueshme shmangia e taksave dhe moszbatimi i ligjeve dhe rregulloreve tjera të punës. Këto konsiderata do të sugjerorin që në vend se të reduktohet roli i qeverisë në ekonomi, hartuesit e politikave të koncentrohen në rritjen e efikasitetit të intervencimeve qeveritare. Për “qeverisjen e mirë” është shkruar e folur shumë. Ky koncept shoqërohet me politika të përgjithshme “të një fotografie të madhe”, si promovimi i demokracisë, sundimi i ligjit, dhe krijimi i marrëdhënieve më të hapura ndërmjet qeverisë, sektorit bankar dhe industrisë. Por, qeverisja e mirë është njësoj e vlefshme edhe për sektorin informal. Përmirësimi i transparencës dhe zbatimi i vazhdueshëm i rregullave dhe rregulloreve mbi lejet për ndërtim, rregulloret e shëndetit dhe sigurisë, lejet për punë, regjistrimi në autoritetet lokale e nacionale të taksave, dhe regjistrimi në institucionet përgjegjëse për kontratat e punës dhe të çështjeve sociale do të përmirësonte imazhin e organizatave qeveritare përgjegjëse për këto funksione, dhe në kthim kjo mund të kontribuojë drejt një zbatimi më të gjërë të këtyre rregulloreve.

Në shumë shtete sistemi i administrimit të punës është me personel të pamjaftueshëm dhe pak i pajisur. Pasurimi i resurseve dhe personelit të trajnuar për këto funksione është një konkluzion që qeveritë gjithsesi duhet ta implementojnë nëse janë serioze për të integruar sektorin informal në kuadër të ekonomisë formale. Mirëpo, kjo do të ishte një zgjidhje jashtëzakonisht e

thjeshtësuar për një problem kompleks me të cilin përballen inspektorët e punës në përpjekjet e tyre për zbatim të ligjit në mikrondërmarrje. Inspektorët e punës shpesh janë të vetëdijshëm rreth kushteve të vështira të punës në të cilat veprojnë këto njësi të vogla dhe rreth faktit se ato nuk mund t'i përballojnë të gjitha shpenzimet e masave ligjore. Rrjedhimisht, në disa shtete inspeksionet e punës zbatohen në mënyrë fleksibile. Ata, në bazë të rastit, vendosin nivelin e zbatimit i cili kërkohet nga secili ndërmarrës. Sindikatat mund të shqyrtojnë promovimin e idesë që inspektorët e punës të hartojnë një listë të paisjeve alternative dhe më të lira të sigurisë të cilat duhet përdorë mikrondërmarrësit derisa të arrijnë një nivel të kënaqshëm të qëndrueshmërisë. Mirëpo, në çështjet si liria e organizimit, diskriminimi dhe eksploatimi i punëtorëve nuk ka hapësirë për fleksibilitet, dhe sindikatat duhet të shtyjnë qeveritë që t'i trajtojnë inspektorët e punës dhe që këta të fundit të jenë rigorozë në implementimin e këtyre komponenteve esenciale të legjislacionit të punës.

c) Politikat taksative dhe rregulloret e qeverive lokale

Gjatë shqyrtimit të mënyrave se si sindikatat mund të ndikojnë evoluimin e politikave publike në sektorin informal është e rëndësishme që të mbahet mend edhe se ky sektor është shumë heterogjen, jo vetëm në aspektin e funksioneve që performon, por edhe në aspektin se sa vërtetë “informal” është. Studimet e ILO-s kanë treguar se sektori informal nuk është plotësisht legal e as ilegal. Shumë ndërmarrje zbatojnë rregulloret themelore në nivel lokal dhe kërkojnë leje që u sigurojnë një bazë minimale për punë. Duke bërë kështu, punëdhënësi minimizon rrezikun e të qenit plotësisht ilegal, që do të dëmtonte ekzistencën e ndërmarrjes. Në anën tjetër, të njëjtat ndërmarrje nuk zbatojnë ato masa për të cilat mendojnë se kërkojnë shumë dhe të cilat zbatohen nga niveli qendror, e të cilat janë taksat dhe obligimet që dalin nga ligjet e punës.

Shkalla e zbatimit të ligjit varet nga lokacioni gjeografik i ndërmarrjes, nga madhësia e njësisë dhe nga koha e ekzistimit të saj. Për shembull, ndërmarrjet në qendra urbane ka më shumë gjasa që të respektojnë ligjin dhe rregulloret, ndërsa ato në zona rurale janë më vështirë të arritshme, më larg inspektimit dhe me më pak gjasa për zbatim. Poashtu, sa më shumë njerëz të jenë të angazhuar në ndërmarrje më shumë gjasa se ligjet do të rrespektohen, ndërsa bizneset e një personi apo ato familjare ka më pak gjasa se do të përmbushin obligimet e tyre ligjore.

Kjo dëshmi ka nxitur shumë njerëz të argumentojnë se ne duhet të synojmë rregullimin gradual të sektorit informal dhe të adaptojmë një qasje hap pas hapi për integrimin e këtij sektori në ekonominë formale. Kjo shpie tek rekomandimet se reformat duhet lansuar në nivel komunal, ku shumë mikrondërmarrje pranojnë dhe implementojnë disa rregulla e rregullore.

Tatimet dhe rregulloret tjera të adaptuara në nivel regional dhe qendror duhet të shtrihen tek sektori informal përmes një procesi gradual dhe përsëritës.

Poashtu ka pasur dhe sugjerime se si të zvogëlohen shpenzimet e fuqisë punëtore pa pagesë duke reduktuar ose eliminuar taksat në të ardhura dhe që do të paguheshin nga ndërmarrja që vepron në sektorin formal. Dëshira për të reduktuar “shtrëngesat taksore”, që faktikisht janë dallimet ndërmjet pagave dhe shpenzimeve totale të fuqisë punëtore, për të promovuar punësimin, është propozim për politika që meriton konsideratë të vëmendshme. Teorikisht së paku, do të ishte e mundshme futja në përdorim apo rritja e taksës në vlerë të shtuar, taksat në fitime kapitale, taksat në të ardhura dhe taksa tjera në mënyrë që të kompensohet Shteti për humbjet me heqjen e në taksës në listë të pagave.

Përkrahja për reforma të kësaj natyre do të ndihmonte të demonstrohej se sindikatat janë të njohura dhe brengosura me problemet në të cilat hasin të vetëpunësuarit dhe mikrondërmarrësit e sektorit informal. Për më tepër, sindikatat ndoshta mund të pranojnë dhe përkrahin reformat e kësaj natyre dhe në të njëjtën kohë të kërkojnë iintervenime më sistematike nga Shteti në treg të punës dhe rreth objektivave të shëndosha të diskutuara më herët.

ç) Mbrojtja sociale

Një sërë hulumtimesh kanë indikuar se mikrondërmarrësit që punojnë në sektorin informal shqyrtojnë shpenzimet e kontributeve të punëdhënësit për skemat nacionale të mbrojtjes sociale dhe këtë e paraqesdin si pretekst për të punuar jashtë sektorit formal. Përveç kësaj, shumë qeveri konsiderojnë pasojat buxhetore për intervenim shtetëror në këtë lëmi dhe janë duke eksperimentuar me reforma të sistemeve të sigurimit social ku përfshihet privatizimi i së paku disa komponenteve të mbrojtjes sociale. Lëvizja sindikaliste me të drejtë kundërshton propozimet për reforma më radikale në këtë sferë. Mirëpo, sindikatat janë njësoj të brengosura rreth mospërfshirjes sociale dhe rreth faktit se një pjese domethënëse të fuqisë punëtore u mohohet çdo mbrojtje sociale. Dhe si pasojë, eksitojnë arsye të qëndrueshme pse sindikatat tashmë janë të përfshira në debate rreth të ardhmes së mbrojtjes sociale, dhe do të ishte e pëlqyeshme për të gjetur mënyra për të rritur ndikimin e sindikatave mbi evoluimin e politikave qeveritare të kësaj sfere.

Çështja kryesore në debatin mbi sigurimin social duhet të ishte se si të ofrohet sigurim social për rata që janë më në nevojë, natyrisht përfshirë dhe punëtorët e sektorit informal, me një kosto që mund të përballohet nga vetë

punëtorët, nga punëdhënësit e tyre dhe nga Shteti. Shumë vëzhgues tentimet për të ofruar mbrojtje sociale të barabartë dhe universale për të gjithë, i kanë parë si faktor për zvogëlimin e pabarazive në të ardhura të një shoqërie.

Pika e parë dhe kryesore, është se qeveritë luajnë një rol të madh rreth redistribuimit të të ardhurave ashtu që të zbusin varfërinë. Së dyti, përgjithësisht është pranuar se qeveritë luajnë njëfarë roli në tentimet që qytetarëve t'u sigurojnë mbrojtje financiare në rast sëmundjeje, invaliditeti, vdekjeje apo pensionimi. Struktura dhe fushëveprim i intervenimeve shtetërore duhet të shqyrtohen në mënyrë shumë të kujdeshme, e në veçanti këto pika:

- (A) në çfarë forme dhe në çfarë niveli do të sigurohet mbrojtje sociale për të gjithë, duke përfshirë dhe punëtorët e sektorit informal;
- (B) burimet e financimit të sigurimit social dhe sa mund një shoqëri në përgjithësi të shpenzojë për mbrojtjen sociale; dhe
- (C) mekanizmat për administrimin e skemave të mbrojtjes sociale në mënyrë të barabartë.

Në çdo debat të tillë janë disa pika të përgjithshme të cilat sindikata ndoshta duhet t'i theksojë. Së pari, sa i përket definimit të mbrojtjes bazike, studime të shumë rasteve kanë dëshmuar se nevojat primare të punëtorëve të sektorit informal janë beneficionet në rast të invaliditetit apo vdekjes të fituesit primar në familje (beneficionet e ekzistencës për familjet e tyre). Në anën tjetër, punëtorët e sektorit formal, që gëzojnë të ardhura stabile dhe më të larta, mendojnë se rëndësi të njëjtë kanë dhe të ardhurat për pensionim. Në shumicën e shteteve sigurimi invalidor dhe jetësor nuk është i shtrenjtë dhe zakonisht nuk duhet të kushtojë më shumë se 3-4 përqind të totalit të fitimeve të siguruara. Sindikatat mund të argumentojnë se të gjitha shtetet duhet të kenë mundësi të përballojnë mbulimin universal bile së paku për këto forma të sigurimit.

Së dyti, në debatet rreth financimit të mbrojtjes sociale sindikatat shpesh konfrontohen nga argumentime që kanë të bëjnë me përqindjen e GDP-së të shpenzuar për mbrojtje sociale. Caktimi i një kufiri kaq të thjeshtë mbi shpenzimet për mbrojtje sociale është jorealiste dhe i padëshirueshëm. Në botën reale është e evidente se shumica që njerëzit janë të gatshëm të paguajnë për sigurim social është ngushtazi e lidhur me llojin e sistemit të mbrojtjes sociale të themeluar. Tipikisht, njerëzit prandaj dhe qeveritë, nuk janë të gatshëm të paguajnë shumica të larta për skema që sigurojnë beneficione “fikse” (p.sh. beneficione që janë të njëjta për të gjithë pavarësisht nivelit të të ardhurave). Në anën tjetër, sistemet universale të mbrojtjes të bazuara në sigurime, në të cilat kontributet dhe beneficionet janë të lidhura me nivelin e të ardhurave të individit, shpesh janë më të pranueshme nga popullata si të përballueshme dhe të dëshirueshme, pavarësisht faktit se ato kushtojnë dy ose tri herë më shumë se sistemet “fikse”.

Së treti, sa i përket mekanizmave për administrim të skemave të mbrojtjes sociale, lëvizja sindikaliste mund t'i konsiderojë intervenimet qeveritare dhe provizionet e transferimit të të ardhurave si të domosdoshme për të siguruar mbrojtje të nevojshme për punëtorët e sektorit informal, sepse të ardhurat që këta punëtorë dërgojnë në shtëpi shpesh nuk janë të barabarta as përmbi linjës së varfërisë. Nga këndvështrimi administrativ, në shumicën e shteteve institucionet ekzistuese të sigurimit social nuk mund të sigurojnë mbulim adekuat të sigurimit për sektorin informal pa bërë ndryshime në strukturat e tyre tradicionale, e që janë ndërtuar për të shërbyer punëtorët e sektorit formal.

d) Politikat makroekonomike

Kritikat që sindikatat dërgojnë drejt politikave ekonomike neoklasike kanë fituar mbështetjen nga anash dhe kanë filluar të japin efekt edhe në institucionet financiare ndërkombëtare. Detyra e cila i pret tani sindikatat është të elaborojnë këto propozime të politikave ekonomike dhe të spjegojnë pse rekomandimet për politika të propozuara nga sindikatat përkojnë drejtpërdrejt me njerëzit apo punëtorët e sektorit informal. Punëtorët e sektorit informal hasin në probleme specifike, siç janë qasja e shtrenjtë dhe e pasigurtë në pronë (tokë). Si rezultat, ata shpesh “pushtojnë” pronën private apo publike apo thjeshtë punojnë në trotuare apo qoshe të rrugëve. Pra, kjo d.m.th. se ata zakonisht nuk kanë qasje në shërbime themelore si furnizimi me ujë a rrymë, dhe përballen me infrastrukturë joadekuate për shembull, rrugët, kanalizimi, dhe qasja në paisje komunikimi e të gjitha këto ndikojnë për të keq në produktivitetin e tyre dhe në mundësitë për zgjerim dhe sukses të biznesit.

Gjatë përshkrimit të problemeve me të cilat përballen, punëtorët e sektorit informal shpesh përmendin tepricën e fuqisë punëtore që zvogëlojnë të ardhurat e tyre, si dhe kërkesën jostabile dhe të pamjaftueshme për produktet e tyre, e më pak ekzistimin e ligjeve të punës dhe rregulloreve qeveritare, si arsye që i detyrojnë ata të punojnë jashtë sektorit formal. Sindikatat vazhdimisht kanë qenë në krye të luftës kundër masave drakonike të stabilizimit që kanë reduktuar të ardhurat, konsumin dhe shpenzimet publike, që kanë shtypur kështu kërkesën dhe kanë rritur pasigurinë e mikrondërmarrjeve dhe individëve që punojnë në sektorin informal.

Për më tepër, këto rezultate sugjerojnë që politikat neoliberaliste të derregullimit të plotë janë kundërproduktive në rast se dëshirojmë të rrisim të ardhurat, profitet dhe produktivitetin në sektorin informal. Për shkak se derregullimi i ligjeve të punës ka gjasa të rezultojë me paga më të ulëta, problemet e kërkesës të përmendur nga punëtorët e sektorit informal do të rëndohen dhe më shumë. Pa ndonjë bazë të strukturës së pagave do të

krijohet një rreth vicioz ku pagat e ulëta do të ndikojnë në rënien e kërkesës dhe do të ktheheshin prapë në paga të ulëta. Zbulimet empirike rreth faktorëve të dekurajimit të njerëzve për të punuar në sektorin informal do të tentojnë të përkrahin rëndësinë e standardeve të punës dhe institucionet si sindikatat që veprojnë si “bllokadë” për krijimin e një rrethi vicioz të tillë dhe që ndihmojnë të gjenerohet një cikël pozitiv që krijon të ardhura, produktivitet dhe prosperitet më të lartë.

dh) Zhvillimi i kapitalit njerëzor

Politikat e promovimit të zhvillimit të kapitalit njerëzor përmes arsimit dhe aftësisë të cilësisë më të lartë janë të rëndësishme vitale për punëtorët e sektorit informal. Rrjedhimisht, fushatat e sindikatave për të promovuar qasje universale dhe pa pagesë në shkollim fillor dhe në arsim e aftësim të nivelit më të lartë janë veçanërisht të rëndësishme për punëtorët e sektorit informal. Por, politikat e sindikatave në këtë sferë ndoshta kërkojnë zhvillim më të madh për t'i bërë më relevante ndaj nevojave specifike të punëtorëve të sektorit informal. Njerëzit në këtë sektor zakonisht kanë nivel të ulët shkollimi dhe aftësitë e tyre për rritjen e prodhimit dhe proceset e marketingut dëmtohen nga mungesa e qasjes së tyre në trajnim. Institucionet formale të trajnimit zakonisht kushtojë shumë dhe kurset e tyre nuk janë të krijuara për njerëz analfabetë ose gjysëm-analfabetë, që d.m.th. se njerëzit në sektorin informal mbështeten pothuaj ekskluzivisht në skema informale të qirakërisë për të përfituar aftësi të reja. Prandaj, reformimi i aftësisë profesionale që të përmbushë më mirë nevojat e punëtorëve të sektorit informal do të ishte shumë i dëshirueshëm.

Politikat e brendshme

a) Përcaktimi i prioriteteve dhe strategjive të organizimit

Ristrukturimi ekonomik në dekadat e fundit ka ndryshuar dramatikisht mënyrën e organizimit të punës, duke i bërë kështu strategjitë tradicionale të organizimit, joefektive. Ka pasur dhe faktorë tjerë që kanë kontribuar në ndryshimin e densitetit sindikalist në shumicën e shteteve. Ajo që është e evidente është se fuqia punëtorë është bërë më e llojllojshme dhe se prioritetet dhe teknikat “tradicionale” të organizimit duhet të rishikohen në bazë të këtyre ndryshimeve. Tashmë, shumë sindikata janë duke tentuar të zgjyërojnë anëtarësinë dhe mandatin e organizatave të tyre. Është mu në këtë kontekst, ku organizimi i punëtorëve “atipikë” të sektorit formal, si dhe i punonjësve dhe i të vetëpunësuarve të sektorit informal, është bërë çështje e

politikave të lëvizjes sindikaliste. Sot realiteti i ekonomive të ristrukturuara dhe fragmentuara dhe individualizimi i marrëdhënieve të punës vështirëson organizimin sindikalist. Me organizim nuk mendohet vetëm në rekrutimin e anëtarëve të rinj dhe ofrimi i shërbimeve për ta. E të njëjtës rëndësi është dhe krijimi i lidhjeve me anëtarët ekzistues, anëtarët potencial dhe me grupe tjera të shoqërisë. Prandaj organizimi nënkupton atë që sindikatat duhet të ripërqëndrohen në punëtorë, pavarësisht statusit të tyre të punësimit apo lidhjes me ndonjë vend të caktuar pune.

Organizimi i të paorganizuarës mund të jetë vendim i rrezikshëm pasi që kthimi i investimeve në resurse njerëzore dhe financiare është i pasigurt. Përveç kësaj, për këtë nevojitet angazhim e përkushtim afatgjatë dhe mund të nevojitet edhe rivlerësimi i perceptimit që sindikatat kanë rreth “bazës” së tyre dhe mënyrës së punës. Lëvizja sindikaliste ka nevojë të shtrihet edhe tek grupe të reja pa zvogëluar bazën tradicionale përkrahëse. Mirëpo, sindikatat i kanë dhënë prioritet organizimit të punëtorëve atipikë dhe informalë, dhe ku përgjithësisht kanë pasur rezultate inkurajuese. Për të vendosur, nëse duhet dhënë prioritet më të madh organizimit të punëtorëve në sektorin informal, ia vlen të merren parasysh disa elemente.

Së pari, si organizata demokratike dhe vullnetare sindikatat kanë nevojë për përkrahjen e anëtarësisë së tyre, udhëheqësisë dhe personelit për të bërë ndonjë ndryshim të politikave sindikaliste. Anëtarët duhet të kenë bindjen se i përkasin organizatës dhe se participojnë në procesin e vendimmarrjes. Personeli duhet të motivohet për të pranuar ndryshimet. Përvojat tregojnë se disa tentativa të udhëheqësisë së sindikatave për organizimin e punëtorëve jotradicionalë kanë dështuar mu për shkak se anëtarësia nuk ka qenë plotësisht e angazhuar në vendimmarrje dhe prandaj nuk ka qenë e përkushtuar për ndryshime në alokimin e resurseve për këto ndryshime. Prandaj, përkrahja e brendshme është parakusht për zhvillim dhe implementim të strategjive të realizueshme që synojnë organizimin e punëtorëve të sektorit informal. Një mënyrë për të arritur tek përkrahja e brendshme është rritja e vetëdijësisë dhe të bindurit e anëtarëve se nga organizimi përfitojnë si ata ashtu dhe të tjerët. Përkushtimi për rritjen e resurseve financiare e njerëzore për organizim, mund të rezultojë nga vetëdijësimi se rritja e anëtarësisë së sindikatave përforcon pozitën për negociim kolektiv të të gjithë punëtorëve dhe përforcon pozitën e sindikatës në arenat politike e sociale. Kongreset dhe konventat e sindikatave zakonisht janë forumet më të përshtatshme për diskutim të angazhimit të sindikatave në organizimin e punëtorëve të sektorit informal, dhe vendimet e marra në këtë nivel zakonisht janë parakusht për veprime pasuese dhe për riorientim të programeve në kuadër të strukturës sindikaliste.

Organizimi mund të kërkojë ndryshime në mënyrën e punës së sindikatave. Disa sindikata kanë themeluar struktura të posaqme përgjegjëse për mobilizim dhe organizim të punëtorëve atipikë. Lidhur me këtë është çështja se çfarë modeli të sindikalizimit, do të përshtatej më së miri në organizim të sektorit informal. “Modeli shërbyes” i sindikalizimit ndërtohet në bazë të

marrëdhënieve “transaksionale” ndërmjet burokracisë së sindikatës dhe anëtarëve të saj. Kjo e fundit paguan një shumë të caktuar në shkëmbim për shërbime. Vazhdimësia e anëtarësisë dhe lojaliteti ndaj sindikatës varet nga satisfakcioni për shërbimet e ofruara. Në shumë shtete në zhvillim, sindikatat zakonisht theksojnë nevojën për të siguruar shërbime të veçanta për punëtorët në sektorin informal, sidomos për femrat punëtoresh, e të cilat shërbime do të luanin funksionin e strategjisë së rekrutimit. Mirëpo, një problem, sidomos nëse përdoret për rekrutim të fuqisë së llojlojshme punëtoresh nga sektori informal, është se sindikatat ndoshta kurrë nuk kanë personel të mjaftueshëm për të përmbushur nevojat dhe kërkesat e të gjithë anëtarëve.

Modeli tjetër është “modeli i organizimit”. Ky model bazohet në bindjet se fuqizimi i punëtorëve u mundëson atyre të gjejnë zgjidhje për problemet e tyre. Ky model i vë theks verpimeve kolektive. Rekrutimi i anëtarëve të rinj zakonisht bëhet përmes kontakteve personale ndërmjet anëtarëve dhe kolegëve të tyre, e jo nga zyrtarët e sindikatës. Mirëpo, me këtë nuk do të thotë se sindikata pushon së ofruari shërbime. Përkundrazi, ato vazhdojnë të sigurojnë shërbime të domosdoshme si këshilla mbi kompensim, avokim të beneficioneve të reja, etj., përmes hulumtimeve dhe marrëveshjeve. Por, ky model i kushton rëndësi të madhe rekrutimit të aktivistëve për të bërë punën e organizimit të kolegëve të tyre dhe thekson një metodologji tjetër për arritjen e objektivave sindikale. Ky model nxitë dhe pjesëmarrjen aktive të anëtarëve në fushata dhe në veprime tjera të sindikatës. Nën këtë qasje, në çdo çështje, sindikata pritet të pyesë anëtarësinë se si mund të arrihen objektivat, e jo duke i lënë anëtarët pasivë e veprimet të gjitha të shkojnë nga zyrtarë të sindikatës.

Nuk ekziston një formulë e vetme dhe e thjeshtë për sukses, dhe në fakt në botën reale nuk ekzistojnë dy modele të ndryshme të sindikalizimit. Asnjë nga elementet e “modelit të organizimit” nuk janë risi për sindikatat. Mirëpo, së bashku këto elemente krijojnë hapësirë për punë drejt një qasjeje sistematike të të organizuarit të një fuqie diverse dhe të shpërndarë punëtoresh përmes procesit nga baza-lart. Vendimet mbi objektivat, synimet dhe strategjitë e implementimit për organizim të fushatave mund të merren vetëm në nivel nacional, ku udhëheqësit relevantë sindikalë kanë informata të mjaftueshme mbi rrethanat dhe eksperiencë të domosdoshme për të marrë vendime të informuara.

b) Formalizimi i qasjes dhe anëtarësimit

Në shumë shtete barrierat ligjore ende parandalojnë punëtorët të bashkohen në sindikata. Disa sindikata kohëve të fundit kanë ndërruar statutet apo strukturat e brendshme të tyre për të akomoduar punëtorët atipikë: këto

iniciativa të reja duhet të konsiderohen si mënyra për të afruar punëtorët ruralë dhe informalë nën ombrellën e organizatave sindikaliste. Amandamentet statutare mbulojnë jo vetëm anëtarësinë, pjesëmarrjen në ekipe negociatore dhe mbulueshmërinë me marrëveshje kolektive, por dhe në shumë raste ofrimin e shërbimeve të veçanta për këta punëtorë, përfshirë dhe ndihmën që ata të rregullojnë statusin e tyre të punësimit. Disa sindikata ofrojnë edhe shërbime sociale, si p.sh. sigurim mjekësor, fonde shëndetësore, beneficione të papunësisë, bashkëpunim dhe asistencë gjatë përbaljes me autoritetet qeveritare, siç janë marrja e lejeve të punës, subvencionimet, tregjet (për punëtorët e sektorit informal), etj. mirëpo, edhe kur një sindikatë ndryshon statutin e saj për të pranuar punëtorë atipikë si anëtarë, këta punëtorë nga kodi i punës mund të jenë të papranueshëm në mbulueshmërinë e marrëveshjeve kolektive. Për këtë arsye, vendimet që mund të parashihen rreth ndryshimeve në strukturat e brendshme të sindikatave dhe rreth alokimit të resurseve duhet të koordinohen me fushatat sindikale të drejtuara kah reformat qeveritare të ligjeve të punës ose, së paku, për zgjerimin e mbulueshmërisë.

Nëse sindikatat vendosin të ndryshojnë kushtetutat apo statutet e tyre që të përfshijnë në anëtarësi edhe punëtorët e sektorit informal, interpretimi i “bazës” sindikale duhet të zgjerohet ashtu që të përfshijë një spektër të gjërë punëtorësh, pavarësisht statusit të tyre të punësimit. Rritja e bazës organizative të sindikatës përmes rritjes së anëtarësisë sigurisht se mund të jetë objektiv afatmesëm. Por në periudhë afatshkurtë sindikatat mund të dëshirojnë të ndihmojnë punëtorët e sektorit informal që të themelojnë shoqatat e tyre dhe të krijojnë marrëdhënie më të ngushta me ta. Kjo iniciativë mund të jetë instrument për krijimin e besimit reciprok, për të zbutur kështu refuzimin e atyre punëtorëve që të bashkohen në sindikatat ekzistuese.

Kjo shpie tek dy konsiderata kryesore, e para, sindikatat duhet të shqyrtojnë se në çfarë baze do të provojnë integrimin e punëtorëve të sektorit informal në kuadër të strukturave ekzistuese sindikale. Nëse ata punëtorë bashkohen në sindikatat ekzistuese apo themelojnë shoqatat e veta të reja që janë të anëtarësuara formalisht në strukturat ekzistuese sindikale nacionale, ata duhet të kenë mundësi të luajnë rolin e tyre në menaxhimin e strukturave sindikale në të njëjtën bazë si dhe anëtarët tjerë. Në anën tjetër, nëse punëtorët e sektorit informal themelojnë organizata të reja që formalisht nuk janë të anëtarësuara në qendrat sindikale nacionale, sindikatat ekzistuese mund të shqyrtojnë ende mundësinë e përfshirjes së udhëheqësve të grupeve informale në diskutime të prioriteteve dhe strategjive në mënyrë që të përforcohen lidhjet ndërmjet sindikatave dhe grupeve të sektorit informal.

E dyta, pagesat e rregullta të anëtarësisë ndonjëherë mund të jenë shkaktare të mosanëtarësimi të punëtorëve të sektorit informal në sindikata. Edhe në këtë rast, mund të gjenden zgjidhje alternative. Disa sindikata, për shembull,

janë pajtuar të caktojnë pagesa më të ulëta të anëtarësisë për punëtorët e sektorit informal. Tjerat ofrojnë periudha “grace” (të tolerancës) deri njëvjeçare në mënyrë që pagesa mos të jetë shkaktare e mosanëtarësimi. Është e qartë se në të dyja rastet miratimi nga anëtarët ekzistues është esencial për implementim të vendimeve të tilla.

c) Ndërtimi i aleancave dhe sindikalizmi komunitar

Natyra e fuqisë punëtore të sektorit informal e bën të vështirë punën e sindikatave. Edhe pse nga jashtë duket “i paorganizuar” sektori informal ka rregullat e veta, ku lidhjet etnike, familjare dhe miqësore janë më të rëndësishme se sa solidariteti i klasës punëtore.

Punëtorët e sektorit informal shpesh përballen me probleme të përditshme dhe jo gjithmonë janë të gatshëm të bashkangjiten në protesta kolektive apo të marrin pjesë në veprime industriale, sepse nuk e dinë se sa do t’ju ndihmonin këto veprime të zgjedhin problemet e tyre praktike në të cilat hasin. Përprjekjet për të nxitur bashkëpunim më të ngushtë me sindikatat janë dëshmuar më të vështira për shkak se metodat tradicionale të organizimit zakonisht janë të papërshtatshme për të arritur tek sektori informal, ku punëtorët janë të shpërndarë dhe punëdhënësit vështirë të identifikohen.

Prandaj hapi i parë dhe më i vështirë për sindikatat është që të vënë kontakt me punëtorët e sektorit informal. Praktikisht, me këtë mendohet që sindikata të shkojnë t’i kërkojnë ata punëtorë, por kjo nuk është dhe aq e lehtë. Një strategji e rëndësishme që mund të hartohet është që të mbahen gjurmë mbi anëtarët, sepse në tregjet e sotme të punës ka shumë gjasa që njerëzit të ndërrojnë vendet e punës, punësimin dhe që gjatë jetës në punë për disa herë të shndërrohen në të papunësuar. Në shumë raste, anëtarët e sindikatave të punësuar në sektorin formal por kanë të afërm në sektorin informal mund të shërbejnë si “urë” ndërmjet sindikatave dhe punëtorëve në fjalë. Ndonjëherë, anëtarët që janë detyruar të kalojnë nga sektori formal në punësim të pastrukturuar mund të shërbejnë si lidhje e mundshme me punëtorët e sektorit informal. Një mënyrë që është dëshmuar e suksesshme për të arritur tek punëtorët e këtij sektori është krijimi i lidhjeve me shoqatat e zanatlinjëve.

Aty ku qasja në vend të punës është e pamundshme, si në rastin e punëtorëve nga shtëpia apo ndihmësit shtëpiakë, qasja e “bazuar në komunitet” do të ishte mjaft e dobishme. Me këtë nënkuptohet puna intensive me organizata të komuniteteve që punësojnë punëtorë në kuadër të sindikatave e të cilët kanë kontakte të ngushta me komunitetin.

Kriteret për krijim të aleancave dallojnë shumë nga vendi në vend. Por, për shumë sindikata është bërë e qartë se ekziston nevoja për një partneritet të fortë ndërmjet lëvizjes së punëtorëve dhe komuniteteve me qëllim “të

organizimit të të paorganizuarës' apo të mobilizimit rreth çështjeve sociale. Si dhe çdo aktivitet tjetër i sindikatave, aleanca duhet të ketë qëllime të qarta dhe strategji të mirë planifikuar. Të gjithë partnerët e përfshirë duhet të dijnë se përfitojnë nëse kyçen dhe të kenë bindjen se interesat e tyre do të merren parasysh. Aleancat në bazë të qëllimit janë më të zakonshmet. Grupet e grave shpesh janë shumë aktive në luftën për të drejta të njeriut dhe nuk frikohen të marrin pjesë në demonstrata apo të angazhohen në aktivitete greviste, dhe prandaj janë potencial i rëndësishëm për secilën sindikatë.

Edhe pse aleancat ndërmjet sindikatave dhe grupeve të komuniteteve zakonisht formohen në bazë të çështjeve specifike, ato mund të rezultojnë dhe me raporte të vazhdueshme nëse disa objektiva apo interesa janë të përbashkëta. Arsyetimi për "sindikalizmin komunitar" vjen në bazë të njohjes së faktit se sindikatat nuk mund të veprojnë të izoluar por në betejat e tyre duhet të përfshijnë dhe organizatat e komunitetit. Organizatat komunitare të përfshira mund të jenë grupet e avokimit siç janë grupet për të drejtat civile apo të pakicave, organizatat religjioze, grupet ambientaliste, organizatat për të drejtat e grave, etj. Një nga përparësitë e sindikalizimit komunitar është se ky mundëson solidaritetin ndërmjet punëtorëve, pavarësisht se a janë anëtarë apo jo të sindikatave lidhur me qëllimet e komunitetit. Në këtë mënyrë, punëtorët e paanëtarësuar mund të fitojnë besim në aktivitetet e organizimit sindikal.

ç) Dimensionin gjinor

Në shumë pjesë të botës gratë (femrat) punojnë në vende të organizuara pune, por në lokacione dhe profesione që janë të paarritshme apo të fshehura nga inspektorët e punës apo nga ligjet e punës. Prandaj, ky fakt dëshmon se duhet punuar shumë në ndërtimin e strategjive gjinore për punëtorët e sektorit informal.

Një strategji e suksesshme e mobilizimit të grave, veçanërisht ato të zonave rurale, është të krijohet lidhje ndërmjet aktiviteteve ekonomike kooperative me sindikatat. Kooperativat zakonisht në mënyrë simultane ndjekin objektivat ekonomike dhe ato sociale. Trajnimi shëndetësor, planifikimi familjar, objektet për kujdes ndaj fëmijëve dhe kurset e lexim-shkrimit shpesh organizohen në kuadër të kooperativave. Ato janë dëshmuar të suksesshme në fuqizimin e grave dhe në vetëdijësimin e tyre rreth përfitimeve nga anëtarësimi në sindikata. Ajo çfarë është dëshmuar e suksesshme në përfshirjen e grave janë edhe mbajtja e ngjarjeve të rregullta (si takimet apo grupet e vogla të studimit, debatet, seminarët dhe seancat e trajnimit) në kohëra dhe lokacione të përshtatshme për to (për shembull të dielave). Mbrojtja e pikëpamjeve të grave dhe të dëgjuarit e problemeve të tyre në forume ku ato mund të shprehen lirshëm duket se është strategji më efektive sesa vetëm informimi mbi të drejtat e tyre.

Në mesin e arsyeve që pengojnë femrat të anëtarësohen në sindikatë mund të theksohen dhe këto: mungesa e njohurive se si sindikata mund të ndihmojë

ato, frika e keqtrajtimin nga punëdhënësit, konflikti me përgjegjësitë familjare, kultura e dominimit të aktiviteteve sindikale nga ana e meshkujve, mungesa e njohurive të sindikatës mbi nevojat e grave punëtore, mungesa e besimit në sindikata, normat ose pengesat fetare/kulturore, dominimi i femrave në format atipike të punës dhe vështirësitë për të arritur tek ato, refuzimi nga bashkëshortët apo familjet, pagesa e anëtarësisë, imazhi negativ me të cilin mediat portretizohet sindikata, etj.etj.

Në bazë të këtyre vështirësive, është e qartë se ndërgjegjësimi apo vetëdijësimi është më se i rëndësishëm për sensibilizimin e grave rreth përfitimeve nga sindikalizmi. Që sindikatat të jenë të besueshme dhe tërheqëse për gratë e sektorit informal, duhet bërë përpjekje të mirëfillta për promovim të barazisë në vende të punës dhe në strukturat sindikale. Në kuadër të organizatave nacionale e ndërkombëtare sindikale është evidente se njësitë e specializuara të dedikuara për çështje gjinore shpesh luajnë një rol qëndror në përmirësimin e imazhit të sindikatave dhe në krijimin e shërbimeve të reja për gratë anëtare, si dhe në implementimin e përpjekjeve sindikale që kanë gjeneruar më shumë sukses. Më herët ka pasur aktivitete që kanë siguruar që nevojat specifike të grave të reflektohen në strategjitë e marrëveshjeve kolektive.

d) Mobilizimi i të rinjëve

Të rinjtë në sektorin informal përbëjnë një grup të rëndësishëm në fokus, sepse ata janë njerëzit që nesër do të hyjnë në treg të punës. Në shumicën absolute të shteteve sindikalizimi i të rinjëve është jashtëzakonisht i ulët. Së fundi, me theksin e vënë për organizim të paorganizuarës, shumë sindikata në tërë botën i kanë kushtuar vëmendje gjithnjë e më të madhe punëtorëve të rinj. Në vend se të flasin "për" të rinjtë, sindikatat kanë filluar të flasin "me" të rinjtë. Por për të biseduar me të rinjtë duhet së pari ditur gjuhën e tyre. Për këtë arsye shumë sindikata kanë themeluar struktura (si departamente, komitete, grupe) për të vënë dialog dhe për të promovuar programe vetëm e vetëm për të rinjtë. Disa sindikata kanë filluar aktivitetet për të rinjtë nëpër shkolla, duke shfrytëzuar këto të fundit si aleatë për të promovuar përfitimet nga anëtarësimi në sindikatë, ndërsa disa sindikata veprojnë nëpër qendra rinore apo shtrihen tek të rinjtë përmes aktiviteteve të tyre rekreative. Në nivel të komunitetit lokal, sindikatat mund të organizojnë aktivitete sociale në bashkëpunim me sportistë të ndryshëm, si futbollistë, basketbollistë apo me ekipe tjera sportive në të cilat marrin pjesë të rinjtë. Ekipet sportive mund të sponsohen apo aranzhohen në atë mënyrë që të koincidojnë me aktivitete sportive që tërheqin audiencë të mëdha. Aty ku është e mundur, sindikatat mund të inkurajojnë idhujt e sportit të shpjegojnë nevojën për veprime kolektive dhe "shpirtin ekipor" në mesin e punëtorëve. E njëjta porosi mund të emitohet përmes industrisë së argëtimit e cila sigurisht se do

të arrijë tek një audiencë edhe më e madhe sesa që do të arrinte mediumi sportiv. Gjatë krijimit të mënyrave inovative për të joshur të rinjtë është e rëndësishme që sindikatat të krijojnë lidhje të qarta me aktivitetin ose mediumin e shfrytëzuar dhe çështjeve të sindikatës. Është e rëndësishme që sindikatat të mos shihen si vetëm një OJQ më tepër e cila promovon aktivitete rinore.

Të ndihmohet të rinjtë të gjejnë vendin e parë të punës është dhe një mënyrë shumë e mirë që sindikatat të demonstronë vlerat e tyre karshi të të rinjëve. Në këtë aspekt sindikatat mund të sigurojnë skema trajnimi për kërkim të vendit të punës dhe për teknikat e intervistimit apo ndoshta dhe kurse më të elaboruara të ngritjes së aftësive.

dh) Ndërgjegjësimi dhe mediat

Një parakusht për të bindur punëtorët që të bashkëpunojnë me apo dhe ndoshta të anëtarësohen në sindikatë është ndërgjegjësimi mbi të drejtat e tyre si punëtorë dhe ndërgjegjësimi mbi beneficionet nga anëtarësimi. Me fjalë tjera, është shumë e rëndësishme që ata të kuptojnë se anëtarësimi në sindikatë është çështje e së sotmes e jo e së kaluarës. Strategjitë inovative janë të domosdoshme sepse punëtorët e sektorit informal janë përgjithësisht të “padukshëm” dhe të shpërndarë, si dhe vështirë të kontaktohen. Është e rëndësishme që këtyre punëtorëve t'u ngritet vetëbesimi dhe vetërespekti si dhe të punohet në atë që të mos ndihen të izoluar.

Një mënyrë për të krijuar solidaritet ndërmjet punëtorëve është ndërmarrja e fushatave të ndërgjegjësimit që fokusohen jo vetëm në të drejtat e tyre ligjore por edhe në sukseset e sindikatave në përmirësimin e pozitës së tyre. Fokusi dhe strategjia e këtyre fushatave sigurisht se duhet të sajohet sipas grupit në fokus.

Mbulueshmëria pozitive e mediave është pjesë integrale e ndërgjegjësimit dhe aktiviteteve mobilizuese të sindikatave. Sindikatat duhet të jenë të dukshme për anëtarët aktualë, të mundshëm si dhe për komunitetin në përgjithësi. Sidomos, në raste kur sindikatat përmirësojnë shërbimet apo adaptojnë politika nga të cilat përfitojnë punëtorët e sektorit informal, porosia duhet të publikohet jo vetëm për çështje organizative por edhe për të fituar përkrahjen e publikut në përgjithësi. Përveç kësaj, nëse qeveritë dhe punëdhënësit janë të vetëdijshëm mbi dëmin në imazhin publik apo në biznesin e tyre nga publiciteti negativ, atëherë ka më shumë gjasa që të ulen e të dëgjojnë se çfarë kanë të thonë sindikatat.

Zgjedhja e mediave më të përshtatshme është komponentë e rëndësishme e një strategjie efektive që synon rritjen e ndërgjegjësimit. Prandaj, mediat e shtypura nuk janë fort të dobishme për të arritur tek shumica e punëtorëve informalë. Radiot janë dëshmuar të jenë instrument efektiv për edukimin rreth çështjeve shëndetësore. Ndoshta sindikatat mund të sponsorojnë emisione apo reklama të shkurta në radio. Për shembull, një porosi e shkurtë që përmban informata rreth rritjes së pagave apo rreth disa përfitimeve që sindikata ka arritur të përfitojë për anëtarët, mund të iniciojë diskutime në komunitetet lokale dhe ngjarje shoqërore mbi sindikatat dhe mbi përfitimet që vijnë nga veprimet kolektive. Apo ndoshta një fushatë radiofonike me një porosi si “Le të dëgjohet zëri juaj: anëtarësohuni në sindikatë”, e pasuar me emrin e sindikatës lokale dhe me informata se si të kontaktohet ajo, mund të jetë mjaft e dobishme. Pra, ekzistojnë variante të panumërta që mund të hulumtohen, përfshirë edhe emisionet radiofonike ku bashkëveprohet me dëgjuesit përmes telefonit.

Është e rëndësishme të dihet se në shumicën e shteteve mediat deri tani kanë pasur tendencë të fortë për të injoruar sindikatat apo t'i portretizojnë ato në dritë negative. Andaj, raportet e fuqishme me mediat duhet të konsiderohen si mjet strategjik për rritjen e ndërgjegjësimit mbi lëvizjen e punëtorëve dhe efektit të saj në komunitet. Joshja e mbulueshmërisë nga mediat është dhe duhet të jetë rezultat i punës sistematike dhe marrëdhënieve të vazhdueshme me reporterë individualë. Në disa shtete pronësia mbi mediat mund të jetë në duar të personave që kundërshtojnë objektivat politike e sociale të sindikatave. Sigurisht që kjo nuk e lehtëson punën e përmirësimit të imazhit të këtyre të fundit. Gazetarët dhe reporterët në zë për paanshmëri dhe objektivitet duhet të inkurajohen që storjet e tyre të paraqesin sindikatën në dritë më pozitive. Përzgjedhja e personit më të përshtatshëm që të veprojë si zëdhënës për media i sindikatave është shumë e rëndësishme: ky sigurisht se duhet të paraqesë imazhin e sindikatës si organizatë dinamike e moderne e përkushtuar drejt përmirësimit të gjendjes sociale e ekonomike për një spektër të gjërë të popullatës, e jo si organizatë që mbron një elitë të privilegjuar.